



INDEKSI KOSOVAR I SHOQËRISË CIVILE

Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile është një studim i rregullt i KCSF-së që ka për qëllim të ofrojë të dhëna dhe vlerësojë gjendjen e shoqërisë civile në Kosovë. Ky studim bëhet çdo dy vite dhe mbulon aspektet kryesore të punës dhe zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë.

PRILL 2014

Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile është përgatitur nga ekipi hulumtues i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

AUTOR

Taulant Hoxha

EKIPI I HULUMTUESËVE TË KCSF-SË

Besnike Koçani

Dren Puka

Rina Dragidella

Rron Zajmi

EKIPI I HULUMTUESËVE TË JASHTËM

Enver Gashi – Udhëheqës i ekipit

Dhurata Prokshi – Hulumtuese në terren

Kenan Pllana – Hulumtues në terren

ZBATIMI I INDEKSIT KOSOVAR TË SHOQËRISË CIVILE ËSHTË PËRKRAHUR FINANCIARISHT NGA TRUSTI BALLKANIK PËR DEMOKRACI (BTD).

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave.....	4
Përmbledhje Ekzekutive.....	5
I. Hyrje.....	7
II. Metodologjia.....	7
III. Të gjeturat.....	10
3.1 Korniza bazë ligjore për funksionimin e OShC-ve.....	10
3.2 Struktura e shoqërisë civile në Kosovë.....	14
3.3 Financimi dhe burimet e financimit.....	24
3.4 Ndikimi i perceptuar.....	43
3.5 Ambienti i Jashtëm.....	50
VI. Shtojcat.....	54
Bibliografia:.....	54
Lista e të intervistuarëve:.....	55
Lista e pjesëmarrësve në takimin validues:.....	56

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Mostra e hulmimit të organizatave	8
Figura 2: Kohëzgjatja e procedurës së regjistrimit të OJQ-ve	11
Figura 3: Kërkesat për raportim tatimor	12
Figura 4: Organi më i lartë vendimarrës në organizatat me anëtarësi (shoqata)	14
Figura 5: Dokumentet e punës që posedojnë organizatat (pyetje me përgjigje të shumëfishta)	15
Figura 6: Raportimi i OShC-ve në ATK	16
Figura 7: Stafit i cili është i përfshirë në urdhërimin dhe ekzekutimin e pagesave (pyetje me përgjigje të shumëfishta).....	17
Figura 8: Dokumentet/informatat e publikuara në uebfaqet e organizatave (pyetje me përgjigje të shumëfishta)	18
Figura 9: Kohëzgjatja e qëndrimit të stafit në raport me buxhetin vjetor të organizatës.....	19
Figura 10: Numri i rrjeteve në të cilat OShC-të janë anëtare.....	20
Figura 11: Takimet ose shkëmbimi i informatave me organizata të njehta ose të ngjashme, brenda dhe jashtë Kosovës.....	21
Figura 12: Përqindja e popullsisë anëtarë të OShC-ve.....	22
Figura 13: Përqindja e popullsisë që janë përfshirë në punën e OShC-ve.....	22
Figura 14: Shërbimet në dispozicion të shoqërisë civile (pyetje me përgjigje të shumëfishta)	23
Figura 15: OShC-të sipas të hyrave vjetore	24
Figura 16: Burimet financiare për OShC.....	25
Figura 17: Raporti në mes të fondeve nga donatorët dhe qarkullimi vjetor të OShC-ve	26
Figura 18: Financimi i OShC-ve sipas perceptimit të jashtëm	27
Figura 19: Të ardhurat e organizatave krahasuar me vitin e kaluar.....	27
Figura 20: Mënyra e financimit të OShC-ve (pyetje me përgjigje të shumëfishta)	28
Figura 21: Planifikimi i punës në OShC.....	29
Figura 22: Aplikimi i OShC-ve për fonde (vlerësim për sektorin në përgjithësi)	30
Figura 23: Përzgjedhja e çështjeve për tu trajtuar (vlerësim për organizatën e tyre).....	30
Figura 24: Numri i donatorëve në OShC gjatë 3 viteve të fundit	32
Figura 25: Organizatat e ftuara për konsultime nga donatorët në raport me të hyrat vjetore	33
Figura 26: Organizatat që kanë përfituar fonde nga BE-ja	34
Figura 27: Organizatat që kanë përfituar fonde nga buxheti i Republikës së Kosovës	35
Figura 28: Shumat që OShC-të kanë përfituar nga fondet e buxhetit të Republikës së Kosovës	36
Figura 29: OShC-të përfituese të donacioneve nga kompanitë private apo individët	39
Figura 30: Arsyet e kompanive private/individëve për dhënie të donacioneve (pyetje me përgjigje të shumëfishta)	39
Figura 31: Përqindja e qytetarëve që bëjnë punë vullnetare.....	40
Figura 32: Mendimi i OShC-ve për rritjen/zvogëlimin e punës vullnetare	41
Figura 33: Organizatat sipas numrit të vullnetarëve.....	41
Figura 34: Organizatat sipas numrit të vullnetarëve të rregullt/të punësuarve me pagë.....	42
Figura 35: Perceptimi mbi ndikim të shoqërisë civile në zhvillim ekonomik/sundim të ligjit.....	43
Figura 36: Fushat e ndikuara më së shumti nga shoqëria civile, sipas perceptimeve të OShC-ve dhe perceptimeve të jashtme	44
Figura 37: Komunikimi i OShC-ve me institucione publike	45
Figura 38: Qasja e OShC-ve në informata publike.....	45
Figura 39: Aprovimi/ Refuzimi i kërkesave për qasje në informata	46
Figura 40: Angazhimi i OShC-ve në hartim të politikave	46
Figura 41: Fushat ku OShC-të kanë qenë aktive, sipas perceptimeve të OShC-ve dhe perceptimeve të jashtme	47
Figura 42: Perceptimet e jashtme për ndikimin e OShC-ve në hartim të politikave	47
Figura 43: OShC-të e ftuara për konsultime nga autoritete publike	48
Figura 44: Ndikimi i OShC-ve në hartim të dokumenteve publike	49
Figura 45: Niveli i besueshmërisë në institucione/sectorë	52

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Auditimet financiare në raport me të hyrat vjetore të OShC-ve	16
Tabela 2: Burimet njerëzore dhe kohëzgjatja e projekteve	19
Tabela 3: Format më të shprehura të përkrahjes për OShC-të në Kosovë (pyetje me përgjigje të shumëfishta)	29
Tabela 4: Ndikimi i donatorëve në punën e OShC-ve	31
Tabela 5: Konsultimi i OShC-ve nga donatorët	33

LISTA E SHKURTESAVE

ATK	Administrata Tatimore të Kosovës
BE	Bashkimi Europian
CIVICUS	Aleanca Botërore për Pjesëmarrjen Qytetare
DRNOJQ	Departamentin për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ
DSK	Down Syndrome Kosova
IPA	Instrumenti i para antarësimit
KCSF	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
Ligji për OJQ	Ligji 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo Qeveritare
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile është një studim i rregullt i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile që ka për qëllim vlerësimin e gjendjes së sektorit të shoqërisë civile në Kosovë, duke matur dimensionet kryesore të këtij sektori në Kosovë: korniza ligjore për funksionimin e OShC–ve, struktura e shoqërisë civile, financimi dhe burimet e financimit, ndikimi i perceptuar i shoqërisë civile, si dhe ambienti i jashtëm në të cilin vepron shoqëria civile. Metodologjia e përdorur për hartimin e këtij studimit, përfshin rishikimin e të dhënave dytësore, organizimin e hulumtimeve parësore sasiore dhe cilësore, analizën e të dhënave si dhe validimin e të gjeturave nëpërmjet diskutimit të me aktorë tjerë brenda dhe jashtë shoqërisë civile. Përderisa numri i organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Kosovë ka kaluar 7,000, ky studim përfshin vetëm organizatat e shoqërisë civile që konsiderohen aktive.

Korniza ligjore për funksionimin e OShC-ve përfshin ligjin bazë për OJQ, i cili në përgjithësi është në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe një numër të vogël të dispozitave tjera relevante që janë të shpërndara nëpër ligje të ndryshme. Zbatimi i ligjeve ekzistuese mbetet jo i kënaqshëm, ndërsa mbeten për t'u plotësuar me legjislacion të ri shumë nën-fusha të rëndësishme të funksionimit të sektorit civil.

Qeverisja e brendshme e OShC-ve është e rregulluar mirë me dokumente të brendshme, por këto dokumente jo gjithmonë zbatohen si duhet në praktikë. Shumica e OShC-ve në Kosovë i përbushin detyrimet ligjore për raportim, ndërsa auditimet financiare i tejkalojnë kërkesat ligjore. OShC-të kërkojnë staf me përvojë dhe kualifikim përkatës, mirëpo e kanë të vështirë që të gjejnë persona të tillë. Atëherë kur i gjejnë dhe i punësojnë, organizatat janë të kënaqura me punën e tyre. Megjithatë, gjysma e organizatave nuk mund t'a mbajnë stafin e tyre më shumë se 2 vite, dhe kjo për arsye që shumica e projekteve që financohen në Kosovë janë më të shkurtëra se 24 muaj. Anëtarësia e qytetarëve në organizata të shoqërisë civile mbetet e ulët, edhe pse OShC-të deklarojnë që konsultohen dhe i përfshijnë anëtarët dhe përfituesit e aktiviteteve të tyre. Megjithatë, çështjet për të cilat angazhohet shoqëria civile gëzojnë një përkrahje më të lartë.

Shoqëria civile në Kosovë mbetet e varur financiarisht nga donatorët ndërkombëtarë, sidomos organizatat që kanë qarkullim më të madh të fondeve. Fondet nga institucionet publike janë në rritje, edhe pse ende nuk janë të rregulluara me procedura dhe kritere ligjore. Burimet tjera të financimit, siç janë shërbimet, tarifat e anëtarësisë ose donacionet private mbesin shumë të ulëta. Forma më e shprehur e dhënies së fondeve është nëpërmjet granteve për projekte në shuma deri në 10,000 ose deri në 25,000 EUR, e që zakonisht zgjasin deri në 12 muaj. Numri i OShC-ve kosovare që përfitojnë fonde të BE-së është në rritje, por procedurat e aplikimit vazhdojnë të konsiderohen të vështira. Vullnetarizmi i qytetarëve nëpërmjet shoqërisë civile mbetet i ulët, madje mund të cilësohet edhe në rënie. Megjithatë, shoqëria civile ka më shumë vullnetarë sesa staf që paguhet.

Shoqëria civile në Kosovë ka ndikim të kufizuar në çështjet që janë brengë kryesore e qytetarëve, siç janë zhvillimi ekonomik dhe sundimi i ligjit. Ndikimi perceptohet si më i ndjeshëm në demokratizim, barazi gjinore dhe përkrahje për komunitetet e varfëra dhe grupet e marginalizuara. Shoqëria civile ka komunikim të mirë me institucionet publike, por ky komunikim nuk përkthehet në qasje të mjaftueshme në informata publike dhe konsultim të duhur në hartim të ligjeve dhe politikave. OShC-të më të mëdha dhe me shtrirje më të gjerë gjeografike janë mjaft të angazhuara në hartim të politikave, por ndikimin e tyre e shohin si të kufizuar. Përderisa përfshirja dhe konsultimi i tyre në përgjithësi shënon një trend pozitiv, mbetet problematike mbyllja e institucioneve dhe përjashtimi i shoqërisë civile nga proceset të cilat konsiderohen që kanë interes të shtuar politik ose ekonomik.

Ambienti i jashtëm në të cilin vepron shoqëria civile nuk është i favorshëm dhe nuk paraqet perspektivë inkurajuese për këtë sektor. Duke qenë një prej shteteve më të varfëra në Europë me pothuaj se gjysmën e popullsisë të papunë, pa rritje ekonomike dhe me korrupsion të shprehur, ekonomia e Kosovës edhe më tutje mbetet në masë të madhe e varur nga dërgesat nga diaspora dhe ndihmat e donatorëve ndërkombëtarë. Ngjashëm me këtë, konteksti socio-politik ofron një hapësirë të kufizuar për zhvillimin e shoqërisë civile. Përkundër përfundimit zyrtar të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë, ligjitimiteti i shtetit mbetet i kufizuar si në rajon poashtu në arenën ndërkombëtare, ndërsa prezenca e misionëve ndërkombëtarë me kompetenca ekzekutive vazhdon. Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë ka karakterizuar vitet e fundit, duke tërhequr vëmendjen nga procese tjera të rëndësishme dhe duke shkaktuar debate të shumta në Kosovë. Përderisa shumë standarde demokratike ekzistojnë në letër, zbatimi i vërtetë i të drejtave dhe lirive politike si dhe sundimi i ligjit mbetet në një shkallë jo të kënaqshme. Në fund, konteksti socio-kulturor paraqitet i ndryshueshëm: përderisa shoqëria civile mbetet ndër sektorët më të besueshëm në Kosovë, niveli i jashtëzakonisht i ulët i besimit ndërpersonal në mes të qytetarëve kosovarë nuk paraqet bazë të mirë për elementin bazë të shoqërisë civile – bashkëpunimin në mes të qytetarëve.

Në fund, është e rëndësishme të theksohet që shoqëria civile paralelisht me anët e veta të forta, është e vetëdijshme për dobësitë që i ka dhe është mjaft vet-kritike në përgjithësi. Duke i ftuar të gjitha organizatat dhe institucionet relevante që të thellojnë studimin dhe analizat në nën-fusha të veçanta të shoqërisë civile, KCSF shpreson që ky studim paraqet një bazë të mirë për trajtimin e këtyre dobësive, por edhe zhvillimin e mëtejshëm të rezultateve dhe sukseseve të deritashme.

I. HYRJE

Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile është një studim i rregullt i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile që ka për qëllim vlerësimin e gjendjes së sektorit të shoqërisë civile në Kosovë. I bazuar në metodologjinë globale dhe përvojën gjatë zbatimit të Indeksit të Shoqërisë Civile të CIVICUS për Kosovë gjatë viteve 2009-2011, Indeksi Kosovar i Shoqërisë Civile synon që të masë dimensionet kryesore të shoqërisë civile bazuar në një metodologji të përshtatur për specifikat e zhvillimit të këtij sektori në Kosovë.

Ky studim vazhdon traditën e KCSF-së në ofrimin e informatave gjithëpërfshirëse për shoqërinë civile, që ka filluar me Antologjinë e shoqërisë civile në vitin 2000, Analizën e shoqërisë civile në Kosovë të vitit 2005 dhe Indeksin e Shoqërisë Civile të CIVICUS për Kosovë të vitit 2011.

Metodologjia e përdorur për hartimin e këtij studimit, përfshin rishikimin, mbledhjen, validimin dhe analizimin e një spektri të gjerë të informatave, duke përfshirë edhe rishikimin e të dhënave dytësore, organizimin e hulumtimeve parësore sasiore dhe cilësore si dhe validimin e të dhënave nëpërmjet diskutimit të të gjeturave me aktorë tjerë brenda dhe jashtë shoqërisë civile.

Të dhënat e shfrytëzuara për këtë studim janë mbledhur gjatë periudhës së verës dhe vjeshtës së vitit 2013, ndërsa janë analizuar dhe validuar deri në fund të po këtij viti.

Përmes këtij studimi janë analizuar pesë fusha të cilat e karakterizojnë punën e shoqërisë civile: korniza ligjore për funksionimin e OShC-ve, struktura e shoqërisë civile, financimi dhe burimet e financimit, ndikimi i perceptuar i shoqërisë civile, si dhe ambienti i jashtëm në të cilin vepron shoqëria civile.

II. METODOLOGJIA

Ky studim synon që të japë pasqyrë të shkurtë dhe të saktë për elemente dhe dimensione të ndryshme të shoqërisë civile në periudhën aktuale, duke i trajtuar karakteristikat e përbashkëta të sektorit. Përderisa për disa nga temat më të rëndësishme dhe për të cilat janë siguruar të dhëna të mjaftueshme është bërë analizë më e thellë, për një numër të madh të çështjeve tjera identifikohet gjendja aktuale por pa analiza shtruese në secilin element të veçantë. Studimi i identifikon këto tema ku ka nevojë për analiza dhe studime më të thella.

Edhe pse e bazuar në metodologjinë globale të CIVICUS, metodologjia e përdorur për këtë studim është thjeshtëzuar dhe përshtatur dukshëm, me qëllim të trajtimit të elementeve specifike të zhvillimit të shoqërisë civile në Kosovë.

Të dhënat janë mbledhur dhe përpunuar me metodologji të kombinuar sasiore dhe cilësore. Kjo metodologji përfshinë mbledhjen, shqyrtimin, analizimin dhe validimin e shumë të dhënave parësore dhe dytësore, nëpërmjet instrumenteve në vijim:

- Hulumtimi i literaturës për legjislacionin, raportet relevante dhe të dhënat e papublikuara;
- Hulumtimi i organizatave (me 100 OShC aktive në Kosovë);
- Hulumtimi i perceptimeve të jashtme (me 30 përfaqësues të spikatur të sektorëve të ndryshëm jashtë shoqërisë civile);
- Hulumtimi popullsisë (me 1,300 respondentë), përmes përfshirjes së pyetjeve të dedikuara për këtë studim në pyetësonin e rregullt të Pulsit Publik të UNDP-së;

- Intervista të thella për çështje specifike;
- Analizat e thjeshta dhe të kombinuara të të dhënave sasiore;
- Analizat e thelluara tematike; dhe
- Diskutimi dhe validimi i të gjeturave përfundimtare me aktorë të përzgjedhur të shoqërisë civile dhe të sektorëve tjerë.

Nga të gjitha instrumentet e përdorura për mbledhjen e të dhënave, më të rëndësishmet kanë qenë tri hulumtimet e mëdha sasiore: Hulumtimi i organizatave, Hulumtimi i perceptimeve të jashtme si dhe Hulumtimi i popullsisë.

Hulumtimi i organizatave ka përzgjedhur 100 OShC aktive¹ në Kosovë në bazë të një mostre përfaqësuese që siguron përfshirjen proporcionale të llojeve të ndryshme të OShC-ve, dhe atë: 10 OShC që konsiderohen të mëdha dhe të zhvilluara, 10 OShC që konsiderohen të vogla por pak të zhvilluara, por mbeten aktive, 40 OShC të shpërndara nëpër sektorë të ndryshëm tematik, 40 OShC të shpërndara nëpër rajone




Figura 1: Mostra e hulumtimit të organizatave

të ndryshme gjeografike të Kosovës. Për më tepër, kjo mostër ka marrë parasysh edhe përfshirjen e një numri të caktuar të organizatave minoritare përgjatë nën-kategorive të ndryshme të mostrës. Vlen të theksohet se ky studim nuk i trajton sindikatat e punëtorëve, mediat dhe komunitetet fetare, edhe pse në teori këto grupe mund të konsiderohen pjesë e shoqërisë civile.

Hulumtimi i perceptimeve të jashtme ka përzgjedhur 30 përfaqësues të sektorëve të ndryshëm jashtë shoqërisë civile siç janë Kuvendi, Qeveria, partitë politike, komunat, gjykatat, univerzitetet, kultura, sektori privat, komunitetet fetare, etj.

Hulumtimi i popullsisë është bërë me 1,300 respondentë nga e gjithë Kosova, të cilët i janë përgjigjur një numri të kufizuar të pyetjeve rreth anëtarësimit në shoqata, punës vullnetare, përfitimeve nga puna e shoqërisë civile, besimit në shoqëri civile dhe besimit ndërpersonal.

Për temat për të cilat të dhënat sasiore nuk kanë mjaftuar për të konstatuar gjendjen aktuale, janë zhvilluar intervista të thella me njohës të fushave të ndryshme nga sektorë të ndryshëm. Përgjatë procesimit dhe analizës së të dhënave, ekipi i hulumtimit ka analizuar secilën të dhënë veç e veç, për të vazhduar me analizë të kombinuar të pjesëve të caktuara të të dhënave në raport me njëra tjetrën. Të gjeturat fillestare janë diskutuar nga një ekip i zgjeruar i KCSF-së, i cili ka bërë analizën dhe ndërlidhjen tematike të të dhënave të ndryshme në dispozicion.

¹ Janë konsideruar aktive ato organizata të cilat minimalisht vazhdojnë të përgjigjen në e-maila ose deklarohen në emër të organizatës së tyre

Drafti parafinal i'u është prezantuar një grupi të përzgjedhur të përfaqësuesëve të shoqërisë civile, qeverisë, institucioneve të pavarura dhe donatorëve me të cilët janë diskutuar dhe validuar të dhënat dhe të gjeturat kryesore. Një numër i rekomandimeve nga ky takim validues kanë ndikuar në përmirësimin e draftit përfundimtar.

III. TË GJETURAT

3.1 KORNIZA BAZË LIGJORE PËR FUNKSIONIMIN E OSHC-VE

Organizatave të shoqërisë civile veprojnë në pajtueshmëri me rendin juridik dhe kornizën ligjore të aplikueshme në vendin në të cilin ato veprojnë, sikurse edhe me parimet e së drejtës ndërkombëtare. Në nivelin ndërkombëtar, janë disa dokumente që i përcaktojnë parimet kryesore të së drejtës së sektorit jo-përfitim, duke filluar nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Rekomandimi CM/Rec(2007)14 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare rreth statusit ligjor të organizatave jo-qeveritare në Europë, etj. Legjislacioni kombëtar duhet të jetë në përputhje me parimet e këtyre dokumenteve ndërkombëtare.

Në Kosovë, liria e asociimit është e garantuar me Kushtetutë (Neni 44) si dhe e përcaktuar në Ligjin 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në OJQ. Forma ligjore me anë të të cilave mund të ushtrohet kjo liri në bazë të këtij ligji përfshin shoqatat dhe fondacionet. Sindikatat, partitë politike, shoqatat e punëdhënësve, komunitetet fetare etj, janë forma të shoqatave të cilat janë të rregulluara me ligjet tjera përkatëse ose ende nuk janë të rregulluara ligjërisht. Regjistrimi nuk është i obliguar, edhe pse shumica e organizatave të shoqërisë civile që janë aktive në Kosovë janë të regjistruara si OJQ. Për këtë arsye, korniza ligjore që e prek drejtpërdrejtë këtë sektor kryesisht përfshihet në Ligjin për Liri të Asociimit në OJQ (në praktikë i quajtur “Ligji për OJQ”), i cili rregullon elementet kryesore të themelimit, organizimit, qeverisjes së brendshme dhe shuarjes së OJQ-ve, si dhe elementet kryesore të Statusit për Përfitim Publik. Përveç këtij ligji, punën e përditshme të organizatave të shoqërisë civile e ndikojnë drejtpërdrejtë edhe ligjet

Prej 7,452 OJQ-ve të regjistruara në dhjetor 2013, 6,947 janë vendore dhe 505 OJQ të huaja/ndërkombëtare. Nga OJQ-të vendore, 6,695 janë shoqata dhe 252 fondacione.

që kanë të bëjnë me çështjet fiskale/tatimore (Ligji për Tatim në të ardhura personale, Ligji për Tatim në të ardhura të Korporatave, Ligji për TVSH), ligjet dhe rregulloret që e përcaktojnë mënyrën e punës së institucioneve me të cilat këto organizata ndërveprojnë (Rregullora e Punës e Kuvendit të Kosovës, Rregullorja e Punës e Qeverisë, Ligji për Vetqeverisje Lokale dhe Statutet e Komunave, Ligji për Qasje në Dokumente Publike, Ligji për Nisma Legjislative, etj), si dhe ligjet specifike të fushëveprimtarisë përkatëse të organizatave të ndryshme. Megjithatë, korniza ligjore ende nuk është e kompletuar si duhet. Nuk ka dispozita ligjore mbi themelimin e kompanive jofitimprurëse apo fondeve investive/të dhurimeve, edhe pse këto të fundit as nuk janë të ndaluara e as të lejuara në mënyrë të qartë. Gjithashtu, një projekt-ligj për sponzorizim ka vite që është në procesin e hartimit në nivel të Qeverisë, por ende nuk ka ndonjë informacion nëse së shpejti do të përcillet për miratim në Kuvend.

Shoqatat mund të themelohen nga të paktën tre persona fizik ose juridik, ndërsa fondacionet mund të themelohen nga një person apo me testament. Për fondacione nuk ka asnjë kërkesë/kushtëzim për shumën e fondeve fillestare ose minimale që nevojiten për themelimin, që ka rezultuar me pjesën më të madhe të fondacioneve të themeluara pa asnjë pronë ose pasuri fillestare. Regjistrimi i OJQ-ve nuk është i detyrueshëm, edhe pse shumica dërrmuese e organizatave vendosin të regjistrohen në mënyrë që të fitojnë statusin juridik. Procedurat e regjistrimit janë të thjeshta dhe pa pagesë. Regjistrimi bëhet në Departamentin për Regjistrim dhe Ndërlidhje me OJQ, ku dorëzohen dokumentet e kërkuara si: kërkesa, akti i themelimit, statuti, lista e anëtarëve etj. Pas miratimit të kërkesës për regjistrim, OJQ-ja merr çertifikatën e regjistrimit nga ky departament. Sipas ligjit, përgjigja nga Departamenti i Regjistrimit të OJQ-ve, duhet të jepet brenda 60 ditëve. Në praktikë,

shumica e OJQ-ve regjistrohen brenda këtij afati, ndërsa afati më i zakonshëm për regjistrim është rreth 1 muaj (43.60%). Megjithatë, ka raste kur ky afat nuk respektohet, zakonisht për shkak të kërkesave për dokumente shtesë ose ndryshime në statut. Sipas përfaqësuesve të DRNOJQ-së, kohëzgjatja për regjistrim të OJQ-së, në të shumtën e rasteve është edhe më e shkurtër se 1 muaj. Por ka raste kur emri i propozuar është i njëjtë me ndonjë OJQ tjetër, apo dokumentacioni nuk është i kompletuar si duhet, andaj kërkohet përmirësimi apo kompletimi i tij. Sipas tyre, ndodhë që aplikuesit për shkak të neglizhencës nuk vijnë më, ose i vonojnë këto përmirësime apo kompletimin e duhur të dokumentacionit. Ndërsa sa i përket shablloneve për regjistrim, sipas DRNOJQ-së aplikuesit kanë të drejtë të përdorin edhe shabllone tjera.




Figura 2: Kohëzgjatja e procedurës së regjistrimit të OJQ-ve

Ky studim ka testuar procedurat e regjistrimit nëpërmjet përcjelljes së procesit të aplikimit në dy raste, të cilat kanë qenë në përputhje me kërkesat ligjore por jo edhe me shabllonet e ofruara nga DRNOJQ. Në të dyja këto raste, procedurat kanë zgjatur më tepër se 2 muaj, ndërsa disa prej kërkesave nga DRNOJQ kanë dalë jashtë kërkesave ligjore. Për shembull, ligji kërkon të paktën tre persona për të krijuar një shoqatë, ndërsa Departamenti i Regjistrimit të OJQ-ve kërkon një listë shtesë me të paktën 5 anëtarë të shoqatës, si një nga dokumentet e regjistrimit për shoqata. Shpjegimi i ofruar nga zyrtarët e këtij departamenti është që kjo kërkohet bazuar në praktikën e funksionimit të OJQ-ve. Megjithatë, kjo kërkesë nuk ka asnjë bazë ligjore, dhe për më tepër është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me numrin minimal të personave që kanë të drejtë të themelojnë shoqata.

Sa i përket regjistrimit, para dy viteve është dizajnuar një platformë online e regjistrimit, e cila tashmë është vënë në funksion. Megjithatë kjo platformë ende nuk praktikohet shumë, për shkak të pamundësisë për të vulosur dokumentet e regjistrimit përmes këtij sistemi. Mundësia e ankesës ekziston dhe rregullohet me legjislacion sekondar. Mirëpo, është problematik fakti se po të njëjtit autoritet i është dhënë mandati ta themelojë komisionin për ankesa, ndërsa nuk ka rregulla të qarta për funksionimin e këtij komisioni. Shumica e problemeve në fazën e regjistrimit janë pasojë e mungesës së kapaciteteve të mjaftueshme dhe të kuptuarit e kërkesave ligjore nga Departamenti për Regjistrimin e OJQ-ve, i cili është autoriteti përgjegjës i vetëm për regjistrimin e OJQ-ve.

Mund të interpretohet edhe si...

DRNOJQ, në përgjithësi i trajton dhe i përgjigjet kërkesave për regjistrim të OJQ-së brenda afatit ligjor prej 60 ditësh, madje shumë shpesh edhe për 30 ditë. Megjithatë, në rastet kur OJQ-të paraqesin dokumente të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore, por jo sipas shablloneve të DRNOJQ-së, atëherë kjo procedurë ndodh të zgjatet përtej afateve ligjore.

Në përgjithësi, OShC-të në Kosovë veprojnë lirisht, pa ndërhyrje të paarsyeshme të shtetit në qeverisje dhe aktivitetet e tyre të brendshme. Korniza ligjore ndalon autoritetet publike për të ndërhyrë në punën dhe aktivitetet e OJQ-ve, dhe deri më tani nuk ka raste të raportuara të ndërhyrjes së drejtpërdrejtë të shtetit në çështjet e brendshme të OShC-ve. Kërkesat e raportimit janë të dyfishta: raportimi për Administratën Tatimore për transaksionet e tyre financiare si dhe raportimi në Departamentin e Regjistrimit të OJQ-ve për Organizatat me status të përfitimit publik. Kërkesat e raportimit për Administratën Tatimore janë identike për bizneset dhe 53,94% prej OShC-ve të intervistuar konsiderojnë se këto kërkesa nuk janë në përputhje me natyrën specifike të punës së OShC-ve. Në anën tjetër, raportimi i organizatave me status të përfitimit publik (SPP)² bëhet në formë narrative dhe financiare, ndërsa organizatat me SPP me të ardhura me më shumë se 100,000 EUR duhet të paraqesin edhe raportin e auditimit të jashtëm. Megjithatë, raporti narrativ bëhet sipas një formati i cili nuk lejon informimin e duhur si dhe vlerësimin e punës për përfitim publik të OShC-ve.

Ligji 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit e ka një prag më të ulët për pagesat e OShC-ve në krahasim me sektorët tjerë³: OJQ-të duhen të kërkojnë leje të posaçme për pranimin e shumës më të lartë se 1,000 EUR nga një dërgues i vetëm apo për pagesë më të lartë se 5,000 EUR për një pranues të vetëm, brenda një dite. Që të jenë në gjendje të kryejnë apo pranojnë pagesa të cilat i tejkalojnë shumat e specifikuar më lartë, OJQ-ja mund të kërkojë nga Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës (NjIF-K) përjashtim




Figura 3: Kërkesat për raportim tatimor

nga këto obligime për një herë apo për një periudhë të caktuar kohore. Kërkesat me shkrim që i dorëzohen NjIF-K-së nga OJQ-ja duhen të theksojnë llojin e përjashtimit dhe arsyet për këtë përjashtim, derisa NjIF-K-ja duhet t'i përgjigjet kësaj kërkesë brenda tridhjetë (30) ditëve. Përgjigjet e NjIF-K-së mund të jenë: 1) lejohet 2) lejohet me kusht ose 3) refuzohet. Mirëpo i tërë procesi i kërkesës dhe përgjigjes nuk përmban kritere të cilat do të duhej të merren parasysh nga NjIF-K gjatë marrjes së vendimit. Kjo krijon një bazë për interpretime të ndryshme apo vendime arbitrare. Këto kërkesa janë të rënda për OShC-të pasi që ato mund të krijojnë probleme për pranimin e fondeve nga donatorët apo për pagesën e fondeve nga dhënësit vendor të granteve. Për më tepër, sanksionet për shkeljen e këtyre kufizimeve janë problematike në dy aspekte: së pari, ato nuk janë në proporcion me shkallën e shkeljes, pasi që ato lejojnë edhe shuarjen e OJQ-ve; së dyti, ato i japin Departamentit të Regjistrimit të OJQ-ve autoritetin që ta shuaj OJQ-në, e që nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit për Lirinë e Asociimit në OJQ. Mirëpo, deri më tani nuk raportohet që këto dispozita të jenë zbatuar në praktikë. Përveç dispozitave të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dispozitat ligjore mbi shpërbërjen e OJQ-ve të Ligjit për OJQ janë në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare. Mekanizmat e shpërndarjes së aseteve nuk janë funksionale, edhe pse ekziston një udhëzim administrativ për

² Nga gjithsej 1,015 organizata që kanë pasur SPP, aktualisht e gëzojnë këtë status vetëm 231 prej tyre, prej të cilave 157 janë vendore dhe 74 të huaja

³ Ligji 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit – Neni 24

themelimin e Komisionit për Shpërndarjen e Pasurive të mbetura të OJQ-së, mirëpo pa procedura specifike dhe kritere për vendimet e këtij Komisioni.

OShC-të lirisht mund të kërkojnë dhe të sigurojnë burime financiare nga burime të ndryshme vendore dhe të huaja për të mbështetur aktivitetet e tyre. Korniza ligjore i lejon OShC-të për t'u angazhuar në aktivitete të ndryshme ekonomike, poashtu aktivitetet ekonomike që janë të ndërlidhura me misionin e organizatës janë të liruara nga tatimi mbi fitim. Megjithatë, vetëm një numër i OShC-ve angazhohet në aktivitete ekonomike dhe shumë prej tyre nuk janë të njoftuara me detyrimet dhe kufizimet përkatëse. Pranimi i financimit të jashtëm lejohet dhe 74% të burimeve të fondeve të shoqërisë civile vijnë nga donatorët ndërkombëtar. Përveç kësaj, OShC-të mund të pranojnë donacione nga individë, korporata dhe burime tjera, por në praktikë donacionet individuale dhe korporative nuk janë të shprehura. OShC-të nuk janë të liruara nga TVSH-ja. Sidoqoftë, fondet që vijnë nga BE-ja apo shumica e donatorëve bilateral janë të liruara nga TVSH-ja, pavarësisht se cili operator ekonomik operon me këto fonde. Si rezultat, OShC-të të cilat përfitojnë nga këto fonde gjithashtu i nënshtrohen këtij lirimi, vetëm për atë pjesë të fondeve. Mirëpo, procedura e lirimit nuk është e njëjtë për të gjithë donatorët dhe lirimi në praktikë shkakton vështirësi për OShC-të në shumë raste.

3.2 STRUKTURA E SHOQËRISË CIVILE NË KOSOVË

Qeverisja e brendshme e OShC-ve (dokumentet dhe vendimarrja)

Ligji për OJQ i njuh vetëm dy forma të regjistrimit të OJQ-ve: shoqata dhe fondacione.⁴ Shumica e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë janë të regjistruara si organizata me anëtarësi. Sipas të dhënave të DRNOJQ-së të muajit dhjetor 2013, në Kosovë janë të regjistruara 7,452 OJQ, prej të cilave 6,947 janë vendore dhe 505 të huaja. Prej OJQ-ve të regjistruara vendore, 6,695 janë të regjistruara si organizata me anëtarësi (shoqata) dhe vetëm 252 si organizata pa anëtarë (fondacione).

Sipas Ligjit për OJQ, organi më i lartë i shoqatave është Kuvendi i Anëtarëve, ndërsa organi më i lartë i fondacioneve është Bordi i Drejtorëve. Nga mostra totale e organizatave të anketuara, 89 % prej tyre janë deklaruar që janë regjistruar si shoqata, ndërsa 11 % si fondacione. Nëse do të bazoheshim në kërkesat ligjore, atëherë kjo përqindje identike do të duhej të reflektohej edhe në pyetjen e organit më të lartë udhëheqës. Mirëpo, rezultatet dëshmojnë që jo të gjitha shoqatat i përmbahen legjislacionit në fuqi.

Nga organizatat e anketuara, 51.5% prej tyre e kanë deklaruar Kuvendin e Anëtarëve si organin e tyre më të lartë vendim-marrës ndërsa 47% prej tyre e kanë deklaruar Bordin. Përderisa të gjitha fondacionet e anketuara e kanë deklaruar Bordin si organin e tyre më të lartë udhëheqës, vetëm 60 % e shoqatave e kanë deklaruar Kuvendin e Anëtarëve si organin më të lartë udhëheqës, duke bërë që 40% të shoqatave të deklarohen në shpërputhje me kërkesat ligjore në këtë pikë.




Figura 4: Organi më i lartë vendim-marrës në organizatat me anëtarësi (shoqata)

Të pyetur se kush i merr vendimet kyçe në organizatë, organizatat e anketuara deklarojnë që vendim-marrja në organizata ndahet në mes të organit më të lartë udhëheqës dhe Drejtorit Ekzekutiv. Konkretisht, 69.8% të organizatave deklarojnë që rolin kryesor në vendimet kyçe brenda organizatës e ka organi më i lartë udhëheqës (Kuvendi i Anëtarëve ose Bordi), ndërsa gjysma e organizatave e deklarojnë edhe Drejtorin Ekzekutiv si të përfshirë në marrjen e vendimeve kyçe. Vetëm 11.3% të organizatave të anketuara kanë deklaruar që edhe stafi i organizatës është i përfshirë në marrjen e vendimeve kyçe. Megjithatë, ky staf e ka rolin kryesor në përcaktimin e çështjeve që trajtohen nga organizatat (në 74% të organizatave), kryesisht nëpërmjet analizës, hulumtimeve apo kontakteve tjera gjatë punës së tyre të përditshme.

Sipas legjislacionit në fuqi, organi më i lartë udhëheqës duhet të takohet së paku një herë në vit, ndërsa varësisht nga vëllimi dhe dinamika e punëve në organizata kjo mund të ndodhë edhe më

⁴Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Kreu II, Neni 5.

shpesh.⁵ Në këtë drejtim, 96% e organizatave deklarojnë që e kanë plotësuar këtë obligim ligjor, ndërsa 58% prej tyre kanë pasur takime të organit udhëheqës më shumë se 1 herë gjatë vitit të fundit.

Sa i përket dokumenteve të brendshme për rregullimin/organizmin e punës së organizatave, shumica e organizatave kanë deklaruar se posedojnë Rregullorën e Punës, Rregullorën Financiare, etj. Rezultate të ngjajshme janë deklaruar edhe në vitin 2011. Në diskutimet e gjëra gjatë atij viti rreth qeverisjes me vendim-marrje demokratike, e cila fuqimisht theksohet në dokumentet e brendshme të sektorit të shoqërisë civile në Kosovë, është konstatuar që këto rregullore nuk përkthehen në zbatimin e duhur të




Figura 5: Dokumentet e punës që posedojnë organizatat (pyetje me përgjigje të shumëfishta)

këtyre parimeve në praktikë.⁶ Për më tepër, përvoja vetanake e KCSF-së në menaxhimin e skemave të granteve dëshmon që jo të gjitha organizatat që deklarojnë që i posedojnë dokumentet e brendshme i kanë ose zbatojnë ato në praktikë. Gjatë vizitave të organizatave aplikuese në skemat e granteve të KCSF-së, një numër i konsiderueshëm i tyre nuk kanë arritur që të dëshmojnë që i posedojnë ose i zbatojnë në praktikë rregulloret e deklaruara paraprakisht.

Menaxhimi financiar, auditimi dhe raportimi në ATK

Auditimi financiar është një nga format nëpërmjet të cilës OShC-të dëshmojnë që mjetet e shfrytëzuara janë menaxhuar në mënyrë të drejtë dhe të rregullt. Ligji për OJQ kërkon që të gjitha organizatat me Status për përfitim publik që kanë të ardhura vjetore mbi 100,000 EUR të bëjnë auditim të jashtëm financiar. Organizatat tjera që nuk e kanë këtë status (e që paraqesin shumicën e organizatave aktive në Kosovë) nuk kanë ndonjë obligim ligjor për auditim financiar. Megjithatë, praktika dhe parimet e menaxhimit të sektorit civil inkurajojnë organizatat që kanë qarkullim vjetor të konsiderueshëm të ndërmarrin auditime të jashtme financiare, për të dëshmuar që menaxhimi i fondeve në dispozicion bëhet bazuar në parimet e pranuar të kontabilitetit dhe menaxhimit financiar.

Kështu, 37.3% të organizatave të anketuara kanë pasur tre ose më shumë auditime të jashtme financiare, 7.1% prej tyre dy auditime ndërsa 19.2% vetëm një auditim përgjatë tre viteve të fundit. Një numër i konsiderueshëm i organizatave (36.4%) nuk kanë pasur asnjë auditim financiar gjatë tre viteve të fundit. Të gjitha organizatat që nuk kanë pasur auditime financiare i takojnë kategorisë së organizatave me të hyra vjetore nën 10,000 EUR ose nën 50,000 EUR. Nëse analizohen në bazë të të hyrave vjetore, 60.6% e organizatave me të hyra vjetore nën 10,000 EUR si dhe 39.4% e atyre me të hyra nën 50,000 EUR nuk kanë pasur asnjë auditim gjatë tre viteve të fundit.

⁵Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Kreu III, Neni 13, shiquar me 17.10.2013,

⁶KCSF-CIVICUS, Indeksi i Shoqërisë Civile, Qeverisje më e mirë për një ndikim më të madh (2011), p.15

Kjo konfirmon që auditimet financiare janë të vendosura në raport me të hyrat vjetore të organizatave dhe (pa)mundësinë e tyre për të ndërmarrë auditime të jashtme financiare. Për më tepër, vërehet që auditimet financiare nuk janë karakteristikë vetëm e organizatave që kanë të ardhura vjetore mbi 100,000 EUR por ky prag zbret edhe më poshtë, në 50,000 EUR. Mbi 60% e organizatave me të ardhura nga 50,000 deri në 100,000 EUR kanë bërë tre ose më shumë auditime brenda 3 viteve të fundit. Mbetet për t’u studiuar nëse kjo praktikë e mirë e organizatave ndërlidhet më shumë me kërkesat dhe obligimet që ato kanë ndaj donatorëve, apo paraqet shenja të instalimit të një kulture të mirë brenda organizatave.

Sa auditime të jashtme financiare i keni pasur gjatë 3 viteve të fundit?

Cila nga kategoritë e mëposhtme do të përshkruante më së miri të hyrat vjetore të organizatës suaj gjatë vitit të fundit?	Asnjë	1 auditim	2 auditime	3 auditime	Më shumë se 3 auditime	Total
Më pak se 10,000 EUR në vit	76.92	19.23	3.85	0	0	100.0%
10,000 – 50,000 EUR në vit	50.00	23.07	3.84	19.23	3.84	100.0%
50,000 – 100,000 EUR në vit	0	18.75	18.75	37.50	25.00	100.0%
100,000 – 500,000 EUR në vit	0	15.78	5.26	42.10	36.84	100.0%
500,000 – 1,000,000 EUR në vit	0	0	0	75.00	25.00	100.0%
Mbi 1,000,000 EUR në vit	0	0	0	66.66	33.33	100.0%

Tabela 1: Auditimet financiare në raport me të hyrat vjetore të OShC-ve

Sa i përket raportimit, sipas kornizës ligjore të aplikueshme në Kosovë, vetëm organizatat me Status të përfitimit publik janë të obliguara të raportojnë në DRNOJQ për punën e tyre programore dhe aspektin financiar. Organizatat tjera - e që paraqesin shumicën e organizatave aktive në Kosovë - duhet të raportojnë për transaksionet e tyre financiare në Administratën Tatimore të Kosovës, ngjashëm me bizneset. Kështu, 88% e organizatave deklarojnë se raportojnë rregullisht në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa vetëm 12% e organizatave të anketuara kanë deklaruar se nuk raportojnë në këtë institucion. Organizatat që janë deklaruar se nuk raportojnë, kryesisht janë organizata të vogla dhe me të hyra nën 10.000 EUR, ndërsa një numër i tyre janë organizata minoritare.




Figura 6: Raportimi i OShC-ve në ATK

Gjithashtu, shumica e organizatave të shoqërisë civile janë paguese të rregullta të tatimeve bazë. Konkretisht, ato paguajnë në baza të rregullta tatimin në të ardhura personale (84.9%) dhe kontributet pensionale (83%). Gjithashtu, ndër tatimet më të paguara është edhe tatimi në qira, të cilin e paguajnë 44.3% të organizatave të anketuara.

Duke analizuar një aspekt shumë të rëndësishëm të menaxhimit financiar e që është urdhërimi dhe ekzekutimi i pagesave, pozitat më të përfshira janë deklaruar Drejtori Ekzekutiv dhe Zyrtari Financiar. Megjithatë, është interesante të vërehet që Drejtori Ekzekutiv është deklaruar të jetë i përfshirë më shumë sesa Zyrtari Financiar, e që nuk përkon me një ndarje standarde të detyrave të punës brenda një organizate. Kjo konfirmohet edhe nga intervistat me njohës të çështjeve të menaxhimit financiar të OShC-ve, ku vërehet që shpesh herë Drejtorët Ekzekutiv raportojnë te donatorët për shpenzimet financiare, pa përfshirje të zyrtarit për financa. Gjithashtu, organizata të vogla me numër shumë të vogël të stafit mund edhe të mos kenë farë zyrtar të veçantë për financa.




Figura 7: Staf i cili është i përfshirë në urdhërimin dhe ekzekutimin e pagesave (pyetje me përgjigje të shumëfishta)

Në anën tjetër, duke i vlerësuar kapacitetet e veta për menaxhim financiar, 72.3% e organizatave konsiderojnë që kanë nivel të lartë, ndërsa vetëm 2.0% e organizatave mendojnë që kanë nivel të ulët të menaxhimit financiar.

Transparenca

Në Kosovë ekzistojnë pak mekanizma që e dëshmojnë transparencën e organizatave të shoqërisë civile. Faqet e internetit si dhe platformat e ndryshme sociale, tani më janë ndër mjetet më të përdorura nga OShC-të për të promovuar punën dhe aktivitetet e tyre. Në këtë drejtim, 63.4% e organizatave të intervistuar kanë deklaruar që kanë faqe aktive të internetit. Këto organizata janë pyetur se cilat prej informatave/dokumenteve të brendshme i kanë publike në këtë faqe. Rezultatet tregojnë që informatat që kryesisht janë statike ose rrallë të ndryshueshme janë informatat që më së shumti publikohen, siç janë misionet e organizatave (67.9%), aktivitetet kryesore të organizatës (66%), fushat e punës (57.5%). Në anën tjetër, informatat/dokumentet që konsiderohen më të ndjeshme dhe njëkohësisht bazë e llogaridhënies dhe transparencës nuk janë shumë të pranishme në faqet e internetit të organizatave të intervistuar. Kështu, vetëm 17% të organizatave që kanë faqe aktive të internetit i publikojnë raportet e tyre financiare, ndërsa përqindje e ulët poashtu është gjetur edhe te raportet narrative (20.8%) dhe anëtarët e Kuvendit ose Bordit (31.1%). Këto rezultate janë konfirmuar edhe në një studim të ndarë, ku janë kontrolluar faqet e internetit të 70 organizatave, dhe rezultatet kanë dalë të jenë të ngjajshme.⁷

⁷ FORUM 2015, Kush mbikëqyr mbikëqyrësit? - Studim mbi llogaridhënien e shoqërisë civile në Kosovë, Nëntor 2013




Figura 8: Dokumentet/informatat e publikuara në uebfaqet e organizatave (pyetje me përgjigje të shumëfishta)

Burimet njerëzore

Për të analizuar burimet njerëzore në dispozicion të organizatave të shoqërisë civile, ky studim ka trajtuar disa çështje të ndërlidhura të cilat mund të japin një pamje më të gjërë të situatës aktuale. Pyetjet e bëra kanë synuar që të analizojnë të gjithë ciklin e angazhimit të stafit të organizatave, duke filluar nga tregu i punës, numri i stafit të angazhuar, kohëzgjatja e qëndrimit në punë, si dhe përgatitja e stafit të angazhuar në fushën përkatëse. Gjithashtu, këto të dhëna janë analizuar në raport me kohëzgjatjen e projekteve të financuara.

Rezultatet tregojnë që kriteri kyesor të cilin organizatat e shoqërisë civile e përdorin gjatë angazhimit të stafit të ri është përvoja paraprake e punës, ndërsa të rëndësishme janë edhe kualifikimi përkatës arsimor si dhe referencat pozitive nga organizatat partnere. Kështu, 90.6% të organizatave të intervistuar e kanë deklaruar përvojën e punës si kriter të rëndësishëm për punësim, 73.6% prej tyre e kanë deklaruar edhe kualifikimin arsimor, ndërsa 61.3% i vlerësojnë edhe referencat nga organizatat partnere. Megjithatë, kur e vlerësojnë praktikisht se sa tregu i punës ofron persona që i plotësojnë këto kritere, të gjeturat tregojnë që tregu i punës nuk është shumë i favorshëm për organizatat e shoqërisë civile. Shumica e organizatave (73%) e kanë të vështirë ose shumë të vështirë rekrutimin e stafit të përgatitur profesionalisht.

Megjithatë, atëherë kur e gjejnë stafin që e kërkojnë, ata kryesisht vlerësohen të jenë mirë të përgatitur profesionalisht. Kështu, 62.4% të organizatave e vlerësojnë stafin e tyre shumë të përgatitur profesionalisht në fushën e tyre përkatëse, ndërsa 36.6% si mesatarisht të përgatitur. Normalisht, ky rezultat kufizohet vetëm në kënaqshmërinë e vet përfaqësuesëve të intervistuar të organizatave me stafin e tyre, dhe nuk përmban ndonjë indikacion rreth kualifikimit apo performancës reale të tyre.

Tregu i punës - çka kërkohet?		
Përvoja	Kualifikimi	Referencat
90.6	73.6	61.3
Tregu i punës - Sa lehtë/vështirë gjendet stafi?		
Shumë lehtë	Relativisht vështirë	Shumë vështirë
27	60	13
Numri i stafit të paguar		
Deri në 1-3	Deri në 4-8	Mbi 8
31.6	37.9	30.5
Përgatitja profesionale e stafit në fushën përkatëse		
Shumë të përgatitur	Mesatarisht të përgatitur	Dobët i përgatitur
62.4	36.6	1
Kohëzgjatja e projekteve të financuara		
6-12 muaj	12-24 muaj	Mbi 24 muaj
56.6	36.8	20.8

Tabela 2: Burimet njerëzore dhe kohëzgjatja e projekteve

Sa i përket numrit të stafit, shumica e organizatave të shoqërisë civile veprojnë me një numër relativisht të ulët të stafit. 31.6% e organizatave kanë 1-3 staf të paguar, ndërsa 37.9% kanë 4-8 staf të paguar. Në total, 69.5% të organizatave të anketuara nuk kanë të punësuar më shumë se 8 persona.




Figura 9: Kohëzgjatja e qëndrimit të stafit në raport me buxhetin vjetor të organizatës

Rezultatet tregojnë se ka një ndërlidhje në mes të kohëzgjatjes së qëndrimit të stafit si dhe të hyrave dhe projekteve të organizatës. Sipas këtyre rezultateve, sa më të ulëta të hyrat e organizatës aq më i shkurtër është qëndrimi i stafit në atë organizatë, dhe e kundërta. Kështu, tek organizatat me të hyra

vjetore deri në 50.000 EUR stafi qëndron kryesisht 1-2 vite, tek ato me të hyra prej 100.000 EUR deri në 500.000 stafi qëndron kryesisht 3-5 vite, kurse tek organizata me të hyra mbi 1.000.000 EUR stafi qëndron kryesisht mbi 5 vite.

Në anën tjetër, të dhënat tregojnë që numri më i madh i projekteve të shoqërisë civile janë me kohëzgjatje prej 6-12 muaj ose 12-24 muaj. Tek organizatat që kanë projekte që zgjasin më shumë se dy vite, 36.5% e stafit qëndron në të njejtën organizatë më shumë se 3 vite, respektivisht 50% e stafit qëndron mbi 5 vite në të njejtën organizatë. Angazhimi i stafit bazuar në projekte afatshkurtëra mund të jetë një nga arsyet kryesore për qëndrimin e shkurtër të stafit në organizatë.

Mund të interpretohet edhe si...

Organizatat kërkojnë staf me përvojë dhe kualifikim përkatës, mirëpo e kanë të vështirë që të gjejnë persona të tillë. Atëherë kur i gjejnë dhe i punësojnë, organizatat janë të kënaqura me punën e tyre. Megjithatë, gjysma e organizatave nuk mund t’u mbajnë stafin e tyre më shumë se 2 vite, dhe kjo për arsye që shumica e projekteve që financohen në Kosovë janë më të shkurtëra se 24 muaj.

Rrjetet

Rrjetet e organizatave të shoqërisë civile janë një formë e veprimit përmes së cilës organizata të ndryshme të shoqërisë civile mblidhen për të diskutuar dhe punuar në çështjet me interes të përbashkët. Në Kosovë, organizatat e shoqërisë civile janë relativisht mirë të rrjetëzuara, të paktën në aspektin formal. 27.7% të organizatave të intervistuar deklarojnë që janë anëtare të 1-2 rrjeteve, ndërsa 39.6% prej tyre deklarojnë




Figura 10: Numri i rrjeteve në të cilat OShC-të janë anëtare

që janë anëtare të 3-5 rrjeteve. Gjithashtu, ekzistojnë edhe dy ekstreme sa i përket rrjetëzimit: 16.8% të organizatave të intervistuar nuk janë anëtare të asnjë rrjeti, derisa 15.8% prej tyre janë anëtare të më shumë se 5 rrjeteve.

Pavarësisht rrjetëzimit formal, ky studim ka analizuar edhe komunikimin brendasektorial të OShC-ve, respektivisht me organizatat tjera me fusha të njejta ose të ngjashme të veprimit. Sipas studimit, shumica e rrjeteve takohen ose shkëmbejnë informata përmbajtësore për çështje të rrjetit disa herë gjatë vitit (72.6%). Poashtu, të gjeturat tregojnë që në Kosovë ekzistojnë dy lloje të organizatave: grupi i parë që nuk kanë komunikim me organizata tjera (26.7% brenda Kosovës dhe 32.7% jashtë Kosovës), ose komunikimin e kanë të kufizuar me vetëm një organizatë partnere (12.9% brenda Kosovës dhe 10.9% jashtë Kosovës), dhe grupi tjetër që përbën shumicën e që kanë komunikim më të shpeshtë me një numër më të madh të organizatave tjera (60.4% brenda Kosovës dhe 56.4% jashtë Kosovës).




Figura 11: Takimet ose shkëmbimi i informatave me organizata të njejta ose të ngjashme, brenda dhe jashtë Kosovës

Sa për ilustrim, disa nga rrjetet sektorale të cilat kanë qenë aktive gjatë viteve të fundit janë Rrjeti i Grave të Kosovës, Koalicioni për Mbrojtjen e Fëmijëve, Rrjeti i OShC-ve për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID), Demokracia në Veprim (DnV) në nivel qendror, apo edhe Rrjeti i Organizatave Kulturore të Prizrenit në nivel lokal. Gjithashtu, Platforma CiviKos ka shtuar aktivitetin e saj si një rrjet gjithëpërfshirës i organizatave të shoqërisë civile që synojnë strukturimin e bashkëpunimit me institucionet shtetërore.

Përfshirja e qytetarëve dhe anëtarësia

Për arsye të shumta, një nga çështjet më të diskutueshme qysh nga viti 1999 ka qenë mungesa e përfshirjes së qytetarëve dhe anëtarësia e ulët në organizatat e shoqërisë civile në Kosovë. Ngjashëm me të gjeturat e Indeksit të Shoqërisë Civile të vitit 2011⁸, edhe ky studim nxjerr të dhëna shqetësuese mbi nivelin e anëtarësisë. Edhe pse organizatat pretendojnë që kjo përfshirje është më e madhe, qytetarët deklarojnë që janë të përfshirë në punën e shoqërisë civile në një masë shumë të vogël.

Organizatat deklarojnë që në punën e tyre i përfshijnë në nivel të konsiderueshëm edhe përfituesit edhe anëtarët. Sipas deklarimeve të organizatave të anketuara, çështjet që i trajtojnë në kuadër të punës së tyre i bazojnë në nevojat e identifikuar te përfituesit (60%) dhe anëtarët (39%), dhe shpesh nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me përfituesit (41.58%). Megjithatë, grupet e përfituesve ndryshojnë varësisht nga projektet (68.32%). Ngjashëm, kur janë pyetur për numrin e anëtarëve në organizatat e tyre, del se shoqatat mund të ndahen në tre grupe të mëdha: shoqatat me anëtarësi të ulët, të mesme dhe të lartë. Kështu, 1/3 e tyre deklaron të ketë deri në 15 anëtarë, 1/3 nga 15 deri në 80 anëtarë, ndërsa 1/3 e mbetur mbi 80 anëtarë. Në grupin e organizatave që kanë deklaruar më së shumti anëtarë (mbi 80 anëtarë) janë kryesisht organizatat e personave me nevoja të veçanta (si p.sh. HANDIKOS, Shoqata e të Verbërve, Down Syndrom Kosova), organizatat rinore si dhe shoqatat e bizneseve si Oda Ekonomike e Kosovës apo shoqatat e grave në biznes.

⁸ KCSF-CIVICUS, Indeksi i Shoqërisë Civile, Qeverisje më e mirë për një ndikim më të madh (2011)

Rezultatet e hulumtimit të popullsisë tregojnë që vetëm 2% të popullsisë janë anëtarë të një ose më shumë organizatave të shoqërisë civile. Ngjajshëm, përqindje e ulët e qytetarëve kanë deklaruar që kanë përfituar nga ndonjë shërbim i ofruar nga shoqëria civile (3.1%), apo kanë marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga shoqëria civile (6.2%). Megjithatë, në disa intervista të thelluara është theksuar që anëtarësia në të shumtën e rasteve është formale, por jo edhe në nivel praktik të punës së organizatës. Madje shpesh herë stafi i punësuar llogaritet njëkohësisht edhe anëtar i organizatës, ndërsa ka raste kur edhe përfituesit potencial të punës së organizatës llogariten automatikisht si anëtarë. Si ilustrim, Drejtori Ekzekutiv i një organizate nacionale thotë që “organizata e tij i ka 2 milionë anëtarë”, meqenëse nga puna e kësaj organizate përfitojnë të gjithë banorët e Kosovës. Për këto arsye, çështja e anëtarësisë mbetet të studiohet edhe më tej.




Figura 12: Përqindja e popullsisë anëtarë të OShC-ve

Për krahasim, me një nivel pak më të lartë të anëtarësisë dalin të jenë partitë politike, anëtarësinë në të cilat e kanë deklaruar 6.2% të popullsisë. Kjo përparësi e angazhimit në partitë politike në raport me organizatat e shoqërisë civile mund të jetë për shkak të asaj se çfarë presin ata prej këtij anëtarësimi. Partitë politike mund të demonstrojnë një ndikim më të shpejtë, që mund të supozohet të jetë më i dëshirueshëm nga qytetarët në krahasim me ndikimin afatgjatë të organizatave të shoqërisë civile, siç mund të jenë organizatat për të drejtat e njeriut ose për demokratizim.

Përveç anëtarësisë, studimi ka trajtuar përkrahjen nga qytetarët për çështjet/kauzat e ngritura nga organizatat e shoqërisë civile. Edhe pse përfshirja është e ulët në përgjithësi, megjithatë vërehet që një numër më i madh i qytetarëve kanë përkrahur çështje të ngritura nga shoqëria civile (peticione, protesta, etj), sesa që kanë marrë pjesë në aktivitete tjera të shoqërisë civile ose kanë përfituar nga shërbimet e ofruara nga OShC-të. Për ilustrim, disa nga nismat e shoqërisë civile që kanë mbledhur përkrahje domethënëse nga qytetarët gjatë dy viteve të fundit kishin të bëjnë me kundërshtimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, kundërshtimin e faturimit “problematik” të energjisë elektrike, apo edhe peticionin kundër Ligjit për Amnisti. Në anën tjetër, gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe nisma tjera të ngjajshme që nuk kanë hasur përkrahje të njejtë, edhe pse çështjet e trajtuara nga këto nisma janë konsideruar me interes të përgjithshëm.




Figura 13: Përqindja e popullsisë që janë përfshirë në punën e OShC-ve

Organizata përkrahëse për ngritje të kapaciteteve të përgjithshme

Tani për tani, në Kosovë nuk ka shumë qendra të cilat do të ofronin trajnime në fusha të ndryshme për të cilat kanë nevojë OShC-të, sidomos ato organizata që konsiderohen të vogla ose që janë të vendosura jashtë Prishtinës. Ekziston vetëm një numër i vogël i organizatave të cilat konsiderohen si më të konsoliduara dhe të cilat ofrojnë trajnime të caktuara si trajnime për aplikim për fonde të BE-së, konsultime publike, menaxhim financiar, hulumtime, etj. Përkrahja me trajnime dhe forma tjera jo-financiare më shumë bën pjesë në aktivitetet në kuadër të projekteve të caktuara të OShC-ve se sa në ndonjë strategji afatgjate dhe të qëndrueshme.

Gjetjet e këtij studimi tregojnë që vetëm një numër i vogël i organizatave të intervistuar mendojnë që OShC-të kosovare kanë në dispozicion numër të mjaftueshëm të organizatave përkrahëse për ngritje të kapaciteteve të përgjithshme; trajnime relevante për menaxhim të organizatës ose për fushat specifike të veprimtarisë së tyre; këshilla ligjore dhe praktike rreth çështjeve të funksionimit të organizatës ose fushave specifike të veprimtarisë së tyre. Përqindja e organizatave të intervistuar që mendojnë që në Kosovë ka mjaftueshëm organizata, trajnime dhe këshilla të tilla sillet prej 8% deri në 16%. Pjesa tjetër e organizatave mendojnë që shoqëria civile në Kosovë ka në dispozicion mesatarisht ose pak mundësi për të siguruar përkrahje të tillë.




Figura 14: Shërbimet në dispozicion të shoqërisë civile (pyetje me përgjigje të shumëfishta)

3.3 FINANCIMI DHE BURIMET E FINANCIMIT

Organizatet e shoqërisë civile në Kosovë karakterizohen nga nivele të ndryshme të financimit dhe qarkullimit vjetor. Fillimisht, vlen të përsëritet fakti që ky studim trajton organizatat që konsiderohen aktive, dhe jo të gjitha organizatat e regjistruara të shoqërisë civile. Nga organizatat e intervistuar, më shumë se gjysma e tyre i takojnë kategorisë së organizatave me qarkullim vjetor nën 50,000 EUR (56.3%), e brenda këtij grupi, gjysma e tyre kanë qarkullim vjetor nën 10,000 EUR. Pjesa tjetër hyjnë në grupin e organizatave me qarkullim vjetor 50,000 – 100,000 EUR (16.7%) dhe 100,000 – 500,000 EUR (19.8%). Një numër më i vogël i organizatave kanë buxhete më të mëdha që e tejkalojnë shumën prej 500,000 EUR (4.2%) apo edhe 1 milion EUR (3.1%). Sa i përket numrit të projekteve, pjesa më e madhe e tyre kanë më shumë se 3 projekte gjatë vitit (61%), ndërsa 33% e tyre gjatë vitit të fundit kanë zbatuar jo më shumë se 1 ose 2 projekte.




Figura 15: OShC-të sipas të hyrave vjetore

Fatkeqësisht, ende nuk ka një regjistrë të saktë mbi donatorët e huaj dhe vendorë që përkrahin OShC-të në Kosovë. Qeveria e Kosovës e përkrahur nga Zyra e BE-së në Kosovë ka krijuar një platformë digjitale për menaxhimin e ndihmave nga donatorët, por që ende nuk ka arritur të funksionalizohet si duhet.⁹ Të dhënat mbi donatorë janë të pjesshme dhe të mbledhura varësisht sipas nevojave të projekteve të caktuara studimore. Kështu, në bazë të intervistave që KCSF i ka bërë me donatorë të shoqërisë civile për një studim tjetër, nga gjithsej 70 organizata të ndryshme donatore që janë identifikuar si aktive gjatë viteve të fundit, për vetëm 56 prej tyre janë siguruar informata për kontakt dhe vetëm 43 organizata donatore janë përgjigjur në pyetjet e parashtruara, nga të cilat 21 janë agjencitë ndryshme të Kombeve të Bashkuara (KB).¹⁰ Në bazë të kësaj del se një numër i donatorëve nuk janë më aktiv në Kosovë (p.sh. DFID), disa tjerë nuk japin më fonde për

⁹ Platforma për Menaxhimin e Ndhmës/Aid Management Platform-Kosovo, <http://public.amp-mei.net/>

¹⁰ KCSF - Queen Mary, Universiteti i Londrës, Strategjitë dhe praktiket e qëndrueshme të donatorëve për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë (studim i papublikuar si i veçantë)

OShC-të ose për Kosovë (p.sh. EFB), ndërsa një numër tjetër nuk kanë qenë të gatshme që t'i ndajnë të dhënat e tyre për hulumtimin e KCSF-së (p.sh. TIKA).

Pikërisht për shkak të mungesës së ndonjë databaze të përgjithshme apo informatave nga të gjithë donatorët aktivë në Kosovë, është e pamundshme që të llogaritet sasia e përgjithshme e fondeve ndërkombëtare për shoqërinë civile në Kosovë. Megjithatë, pavarësisht mungesës së të dhënave të sakta mbi numrin dhe aktivitetet e donatorëve, një gjë mbetet e sigurtë, e që është varshmëria e madhe e OShC-ve në Kosovë nga donatorët e huaj. Të dhënat nga Indeksi i Shoqërisë Civile për Kosovën (2011) tregojnë se 70.17 % e burimeve financiare për OShC-të vijnë nga donatorët e huaj, ndërsa pjesa tjetër prej 5 % të fondeve vijnë nga donatorët privat, të cilët poashtu ishin kryesisht të huaj.¹¹ Kjo konfirmohet plotësisht edhe nga ky studim, i cili tregon që përqindja më e madhe e burimeve financiare për shoqëri civile vjen nga donatorët e huaj me 74.0% (përfshirë donatorët e huaj privatë).

Përderisa donatorët e huaj vazhdojnë ta mbajnë përqindjen e njejtë në raport me burimet e fondeve për shoqërinë civile, tashmë vërehet një rritje e ndjeshme e përqindjes së fondeve shtetërore në raport me totalin e fondeve për shoqërinë civile në Kosovë. Kështu, derisa në vitet 2010 fondet qeveritare (qendrore dhe lokale) kanë marrë pjesë me 8.84%, tashmë institucionet lokale dhe qendrore sigurojnë 20.5% të fondeve të shoqërisë civile në Kosovë.




Figura 16: Burimet financiare për OShC

Gjithashtu, për dallim nga viti 2010, vërehet një zbritje e të ardhurave nga tarifat e anëtarësisë, nga 5.7% në 0.7%. Megjithatë, një shpjegim i mundshëm për këtë është që në hulumtimin e vitit 2010 janë përfshirë edhe disa sindikata, ndërsa në këtë të fundit këto nuk kanë qenë pjesë e organizatave të anketuara. Gjithashtu, gjatë intervistave të thelluara është theksuar fakti që në një gjendje shumë të rëndë ekonomike është shumë e vështirë që të kërkohet ose pritët që anëtarët të paguajnë tarifa të anëtarësisë. Situatë pak më ndryshe është te shoqatat profesionale, të cilat e kanë më të lehtë që të vendosin tarifa të anëtarësisë për profesionistët e fushës përkatëse. Megjithatë, edhe te këto shoqata janë përmendur raste kur anëtarët fillimisht kanë paguar tarifa të anëtarësisë, mirëpo pas

¹¹ KCSF-CIVICUS, Civil Society Index, Qeverisje më e mirë për një ndikim më të madh (2011)

një kohe e kanë ndërprerë këtë, kryesisht me arsyetimin që kjo pagesë nuk është përkthyer në ndonjë shërbim për vet anëtarët.

Kategoritë tjera të burimeve të financimit mbesin në nivel standard, duke e konfirmuar edhe njëherë që të ardhurat e OShC-ve nga shitjet e shërbimeve të tyre mbesin ende shumë të ulëta.

Duke analizuar llojet e ndryshme të organizatave në raport me burimet e financimit, vërehet që organizatat e vogla që veprojnë në nivel lokal financohen kryesisht nga fondet që jepen nga komunat përkatëse. Shumica e këtyre organizatave qarkullimin vjetor nuk e kanë mbi 10,000 EUR. Madje, ka organizata të cilat nuk kanë aspak fonde nga donatorët e huaj por funksionojnë vetëm bazuar në fonde të vogla, kryesisht komunale.

Një trend tjetër vërehet te organizatat që kanë qarkullim më të madh – sa më i madh të jetë buxheti vjetor i organizatës, aq më i lartë është proporcioni i fondeve që vijnë nga donatorët e huaj. P.sh. 66% e organizatave që kanë qarkullim vjetor mbi 1 milion euro 100 % të fondeve të tyre i sigurojnë nga donatorët e huaj (përfshirë edhe në vetëm një organizatë që ka arritur që të sigurojë të ardhura solide nga shërbimet e ofruara), ndërsa përqindje identike është edhe te organizatat me qarkullim vjetor në mes të 500,000 dhe 1 milion EUR. Ngjashëm, 84% të organizatave me qarkullim vjetor nga 100,000 deri në 500,000 EUR i sigurojnë shumicën e fondeve nga donatorët e huaj, ku më shumë se gjysma e tyre kanë varësi të plotë nga donatorët e huaj.




Figura 17: Raporti në mes të fondeve nga donatorët dhe qarkullimi vjetor të OShC-ve

Këto të dhëna gjithashtu tregojnë që organizatat që konsiderohen më të mëdha, e që kryesisht veprojnë në nivel kombëtar, nuk kanë fare ose kanë shumë pak fonde nga buxheti i Republikës së Kosovës. Gjatë intervistave të thella janë përmendur disa arsye të mundshme: fondet shtetërore janë kryesisht të vogla dhe nuk i përmbushin nevojat dhe kërkesat e këtyre organizatave të mëdha; për shkak të menaxhimit me fonde të mëdha ndërkombëtare, organizatat e mëdha nuk janë të prirura të kërkojnë fonde nga institucionet shtetërore të niveleve të ndryshme; për shkak të mungesës të mekanizmave të duhur për fondet shtetërore, disa organizata hezitojnë që të pranojnë fonde shtetërore me qëllim të ruajtjes së pavarësisë së veprimit.

Është interesant të vërehet që edhe perceptimet nga jashtë shoqërisë civile përkrijnë relativisht shumë me deklaratimet e vet sektorit. Kështu, në pyetjen se si mendojnë që financohen organizatat e shoqërisë civile në Kosovë, të anketuarit jashtë sektorit të shoqërisë civile mendojnë që OShC-të janë financiarisht të varura nga donatorët e huaj (40%) ose kanë burime të ndryshme të financimit dhe nuk janë të varura nga një burim i vetëm (30%), ndërsa 13.3% prej tyre mendojnë që OShC-të janë të varura financiarisht nga fondet shtetërore. Ky perceptim i jashtëm del të jetë i saktë duke marrë parasysh grupet e ndryshme të organizatave: derisa një pjesë e konsiderueshme e organizatave të vogla lokale financohen kryesisht nga fondet publike, organizatat e mëdha kombëtare kanë kryesisht fonde nga donatorët e huaj.




Figura 18: Financimi i OShC-ve sipas perceptimit të jashtëm

Edhe pse nuk ka të dhëna rreth vëllimit të përgjithshëm të fondeve të cilat menaxhohen nga shoqëria civile, ky studim ka analizuar nëse të hyrat e organizatave në përgjithësi janë rritur, zvogëluar ose kanë mbetur të njëjta. Përderisa për një pjesë të konsiderueshme të organizatave (49%) të hyrat nuk kanë ndryshuar gjatë vitit të fundit, për 32.7% të organizatave këto të hyra janë rritur, derisa për 18.4% të organizatave të hyrat janë zvogëluar. Nga një analizë më e thelluar e llojeve të organizatave të cilave i'u janë rritur të hyrat, del se më së shumti rritje kanë pasur organizatat që kanë qarkullim




Figura 19: Të ardhurat e organizatave krahasuar me vitin e kaluar

vjetor nga 100,000 deri në 500,000 EUR (47.36% prej tyre kanë pasur rritje të të hyrave), ndërsa më së paku organizatat e vogla me qarkullim vjetor nën 10,000 EUR.

Përderisa në shumicën e vendeve tjera të rajonit donatorët e huaj janë duke u larguar¹², në Kosovë megjithatë kjo ende nuk është duke ndodhur, ose të paktën jo në një masë që do të vërehej shumë. Nga intervistat që KCSF i ka bërë me donatorë të shoqërisë civile, del që për shumicën e donatorëve të mëdhenjë (USAID, Fondacioni Soros, shtetet e ndryshme të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra), Kosova vazhdon të mbetet në fokusin e asistencës së jashtme. Këtu përfshihet edhe Bashkimi Europian, që në ndihmën e vet të para-anëtarësimin ndan fonde edhe për shoqërinë civile. Ky fokus pritet që të vazhdojë edhe për një kohë të caktuar, të paktën për një të ardhme të afërt. Sipas këtyre intervistave, një nga arsyet kryesore për këtë është që përderisa vendet tjera të rajonit kanë avancuar në agjendën e tyre europiane, Kosova ende mbetet mbrapa në këtë proces. Në këtë situatë, vlerësohet që largimi i shpejtë i donatorëve të huaj do të ishte me pasoja shumë të rënda për zhvillimin e shoqërisë civile, respektivisht do të rrezikonte demokracinë edhe ashtu të brishtë në Kosovë.

Struktura e fondeve dhe procedurat e aplikimit

Nëse bëhet një analizë e strukturës së fondeve për shoqëri civile në Kosovë, rezultatet e këtij studimi tregojnë që forma më e shprehur e dhënies së fondeve është nëpërmjet granteve për projekte, kryesisht bazuar në thirrje të hapur për aplikim, në shumën deri në 10,000 ose deri në 25,000 EUR, e që zakonisht zgjasin deri në 12 muaj.

Forma më e shpeshtë e financimit është e bazuar në thirrjet e hapura për aplikim, ndërsa mjaft i shpeshtë është edhe financimi bazuar në kontakte të drejtpërdrejta me donatorin. Kështu, 84.69% të organizatave kanë deklaruar që kanë përfituar fonde bazuar në thirrjet e hapura për aplikim, derisa 54.08% e organizatave kanë deklaruar raste të financimit bazuar në kontakte të drejtpërdrejta. Më e rrallë deklarohet forma e financimit kur donatori e merr nismën për ta ftuar një organizatë specifike që të zbatojë projekte të caktuara, mënyrë kjo e deklaruar nga 36.73% të organizatave.




Figura 20: Mënyra e financimit të OShC-ve (pyetje me përgjigje të shumëfishta)

Kur janë pyetur se si i vlerësojnë procedurat e aplikimit në raport me fondet që jepen nga donatorët, shumica e organizatave (62.20%) i konsiderojnë këto procedura si mesatarisht të vështira. Megjithatë, është domethënëse përqindja e organizatave (31.60%) të cilat i konsiderojnë këto procedura si të vështira.

¹²Transparency International, Andreë McDevitt –Blerja e ndikimit: Zgjedhjet në Ballkan, 2012

% e organizatave që kanë pasur projekte të financuara në kohëzgjatje prej:		% e organizatave që kanë pasur përkrahje nëpërmjet:		% e organizatave që kanë pasur projekte të financuara në shumë prej:	
Më pak se 6 muaj	21.65%	Grante për projekte	92.78%	Deri në 10,000 EUR	35.79%
6-12 muaj	61.86%	Grante institucionale	19.59%	Deri në 25,000 EUR	33.68%
13-24 muaj	40.21%	Kontrata për shërbime	22.68%	Deri në 50,000 EUR	22.11%
Më shumë se 24 muaj	22.68%	Asistencë teknike	21.65%	Deri në 100,000 EUR	21.05%
				Më shumë se 100,000 EUR	25.26%

Tabela 3: Format më të shprehura të përkrahjes për OShC-të në Kosovë (pyetje me përgjigje të shumëfishta)

Sipas deklarimeve nga organizatat e shoqërisë civile, kohëzgjatja më e shpeshtë e projekteve të financuara nga donatorët del të jetë prej 6 deri në 12 muaj, ku 61.86% të organizatave kanë zbatuar projekte në këtë kohëzgjatje. Gjithashtu, i shprehur është edhe financimi i projekteve deri në 24 muaj, me 40.21% të organizatave që kanë zbatuar projekte me kohëzgjatje të tillë.

Rezultatet e studimit konfirmojnë që donatorët në Kosovë në shumicën e rasteve financojnë grante për projekte, ndërsa format tjera si p.sh. grante institucionale ose kontrata për shërbime janë mjaft të rralla. Kështu, 92.78% të organizatave kanë përfituar grante për projekte, ndërsa vetëm 19.59% prej tyre kanë përfituar ndonjëherë edhe grante institucionale. Përderisa grantet për projekte janë forma më e shpeshtë e financimit, rezultatet tregojnë që këto grante më së shpeshti kufizohen në shumën deri në 10,000 EUR ose 25,000 EUR.

Duke qenë që veprimtaria e organizatave të shoqërisë civile vazhdon të varet kryesisht nga projektet për të cilat sigurojnë financim, kjo mënyrë e financimit ndikon drejtpërdrejtë edhe në planifikimin e punës së tyre. Shumica e organizatave të anketuara punën e tyre nuk arrijnë ta planifikojnë më gjatë se 12 muaj (53.54%), ndërsa një pjesë shumë e vogël e tyre mund të planifikojnë më gjatë se 24 muaj (8.08%). Është e evidente që ky planifikim afat-shkurtër përputhet drejtpërdrejtë me kohëzgjatjen e shumicës së projekteve që financohen nga donatorët.




Figura 21: Planifikimi i punës në OShC

Të gjitha këto të dhëna konfirmojnë supozimin që puna e OShC-ve në Kosovë ende bazohet në projekte afat-shkurtëra, me shumica të vogla dhe pa përkrahje për zhvillimin institucional të tyre. Duke e ditur që në fushat e veprimit të shumicës së OShC-ve ndikimi i duhur mund të arrihet vetëm me intervenime afat-gjate dhe të vazhdueshme, kjo formë e financimit e bën shumë të vështirë ndërtimin e organizatave dhe ndërmarrjen e nismave të qëndrueshme. Gjithashtu, këto të dhëna i konfirmojnë gjetjet që një pjesë e madhe e stafit të organizatave të shoqërisë civile punësohen bazuar në projekte afat-shkurtëra, duke e bërë shumë problematik zhvillimin e kapaciteteve njerëzore në dispozicion të sektorit civil në Kosovë.

Ndikimi i donatorëve në agjendën dhe aktivitetet e OShC-ve

Paralelisht me përfitimet e shumëfishta në zhvillimin e sektorit, përqindja e madhe e fondeve të huaja për shoqërinë civile në Kosovë mund të sjellë me vete edhe rrezikun e ndikimit të agjendave të sektorit nga donatorët e huaj. Ky studim ka synuar që përmes disa pyetjeve të ndërlidhura të arrijë një vlerësim të përafërt të pyetjes nëse varësia e lartë nga donatorët e huaj i ndikon agjendat e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë.

Të dhëna interesante dalin në raport me vlerësimin e vet organizatave rreth temave të cilat i

trajtojnë dhe mënyrës së caktimit të tyre. Kur flasim për organizatën e vet, vetëm 15.80% të organizatave të anketuara vlerësojnë që çështjet që i trajtojnë bazohen në fondet në dispozicion, ndërsa 56.6% prej tyre deklarojnë që organizatat e tyre i dizajnojnë projektet/programet e veta bazuar në kërkesat e përfituesëve. Në anën tjetër, kur pyeten për

sektorin e shoqërisë civile si tërësi, 87.10% vlerësojnë që shumica e OShC-ve aplikojnë për fonde edhe jashtë fushës së veprimtarisë së tyre. Për më tepër, ekziston një perceptim i shprehur që numri më i madh i OShC-ve ashtu se ashtu i kanë misionet mjaft të gjëra. Kjo shpërputhje në mes të vlerësimit për organizatat e veta dhe sektorit në tërësi e sjell nevojën e analizimit më të thellë të kesaj çështje.




Figura 232: Përzgjedhja e çështjeve për tu trajtuar (vlerësim për organizatën e tyre)




Figura 223: Aplikimi i OShC-ve për fonde (vlerësim për sektorin në përgjithësi)

Gjithashtu, organizatat janë pyetur nëse kanë pasur përvoja të ndryshme gjatë bashkëpunimit të tyre me donatorë të huaj, e të cilat normalisht nuk janë në përputhje me parimet e bashkëpunimit. Në shumicën e rasteve, organizatat asnjëherë nuk janë vënë nën presion nga ana e donatorëve për të bërë veprime të cilat përndryshe nuk do t'i kishin bërë. Megjithatë, edhe pse jo të shprehura gjërësisht, disa organizata raportojnë raste kur donatorët kanë kërkuar nga ta që të ndryshojnë natyrën e aktiviteteve të tyre; të shpenzojnë mjete jashtë aktiviteteve të parapara, të bashkëpunojnë me organizata/institucione jashtë dëshirës së tyre apo të kontraktojnë ekspertë të caktuar për shërbime të ndryshme. Edhe pse në raste të rralla, veprime të tilla e çenojnë pavarësinë e veprimit të organizatave të shoqërisë civile, dhe si të tilla nuk duhet të ndodhin.

A ju ka kërkuar donatori që:	Asnjëherë	Rrallë	Shumë shpesh
Të ndryshoni thelbësisht përmbajtjen e projektit të propozuar, jashtë fushës tuaj të veprimtarisë	71%	24%	5%
Të ndryshoni natyrën e aktiviteteve për të cilat jeni financuar paraprakisht	68%	28%	3.1%
Të shpenzoni mjetet e projektit për aktivitete të cilat përndryshe nuk do t'i kishit zbatuar	83%	14.6%	2.1%
Të ftoni ose të mos ftoni pjesëmarrës të caktuar në aktivitetet tuaja	79.2%	16.7%	4.2%
Të mos bashkëpunoni me organizata/institucione të caktuara	91.6%	8.4%	0%
Të bashkëpunoni me organizata/institucione të caktuara me të cilat përndryshe nuk do të kishin bashkëpunuar	84.4%	14.6%	1%
Të largoni ose pranoni dikë në punë	94.8%	5.2%	0%
Të kontraktoni ekspertë/kompani të caktuara të cilat përndryshe nuk do t'i kishit kontraktuar	84.4%	15.6%	0%

Tabela 4: Ndikimi i donatorëve në punën e OShC-ve

Diversifikimi i fondeve, përveç që kontribuon në qëndrueshmërinë e organizatave, gjithashtu edhe e zvogëlon hapësirën e ndikimit të donatorëve në punën e organizatës. Për këtë arsye, organizatat janë pyetur se nga sa donatorë kanë përfiturar fonde gjatë 3 viteve të fundit. Rezultatet tregojnë që shumica e organizatave kanë pasur më shumë se 3 donatorë (64.35%), ndërsa vetëm 29.70% janë financuar nga një ose dy donatorë gjatë tre viteve të fundit.




Figura 24: Numri i donatorëve në OShC gjatë 3 viteve të fundit

Ky rezultat tregon që megjithatë shumica e organizatave të shoqërisë civile përfitojnë nga disa donatorë njëkohësisht, çka e zvogëlon mundësinë e ndikimit në agjendën dhe punën e tyre nga donatorët.

Mund të interpretohet edhe si...

Përkundër që donatorët nuk ndikojnë drejtpërdrejtë në punën e organizatave të shoqërisë civile, vet temat për të cilat ndahen këto fonde në mënyrë të tërthortë e ndikojnë agjendën e shoqërisë civile në Kosovë. Sa më shumë donatorë të ketë një organizatë, aq më të vogla janë mundësitë për t'u ndikuar. Edhe pse në raste të rralla, ndikimet e donatorëve në punën e organizatave e dëmtojnë pavarësinë e veprimit të organizatave të shoqërisë civile.

Përfshirja e OShC-ve në programimin e ndihmës së donatorëve

Përderisa ndikimi i donatorëve vlerësohet të bëhet nëpërmjet temave për të cilat donatorët ndajnë fonde, studimi ka analizuar edhe mënyrën e programimit të fondeve të donatorëve të huaj, respektivisht mënyrën e përcaktimit të fushave dhe temave për t'u financuar.

Të dhënat nga ky studim tregojnë që një numër i konsiderueshëm i organizatave (59.6%) ftohen nga donatorët për konsultime rreth programimit të fondeve të tyre, ose edhe vet organizatat (58%) kërkojnë që të konsultohen nga donatorët. Megjithatë, organizatat deklarojnë që kontributet e tyre merren parasysh shumë pak ose aspak (40.3%) ose mesatarisht (48.1%). Këto të dhëna megjithatë tregojnë që rreth 40% të organizatave të shoqërisë civile nuk u ofrohet mundësia që të japin kontributin e tyre për programimin e fondeve të donatorëve të ndryshëm, ndërsa një numri të konsiderueshëm i atyre organizatave që konsultohen kontributet nuk ju merren parasysh.

OShC-të e ftuara për konsultime nga donatorët:		
Po	Jo	
59.60%	40.40%	
OShC-të që kërkojnë të konsultohen:		
Po	Jo	
58%	42%	
Sa janë marrë parasysh kontributet e OShC-ve		
Aspak ose shumë pak	Mesatarisht	Plotësisht
40.30%	50.50%	11.70%

Tabela 5: Konsultimi i OShC-ve nga donatorët

Sipas disa prej të intervistuarve, gjatë fazës së planifikimit dhe programimit, donatorët konsultojnë kryesisht organizatat e mëdha që konsiderohen si më të konsoliduara. Ndërsa, sa i përket OShC-ve të reja dhe që janë të vendosura në qytete më të vogla, ato pothuajse janë të përjashtuara nga ky proces. Edhe kur marrin pjesë, kontributet e organizatave më të vogla merren parasysh shumë më pak. Kështu, 60% të organizatave me qarkullim vjetor nën 10,000 EUR deklarojnë që edhe atëherë kur janë konsultuar, kontributet e tyre nuk janë marrë parasysh. Sipas organizatës ‘Koha’, e cila është e vendosur në qytezën e Klinës, OShC-të lokale kontaktohen nga donatorët e huaj dhe ata vendorë vetëm nëse ju duhet ndonjë informatë apo kur kanë ndonjë sesion informues për thirrjet për grante.¹³ Kjo konfirmohet edhe nga analiza më e thelluar e organizatave që ftohen për t’u konsultuar nga donatorët.




Figura 25: Organizatat e ftuara për konsultime nga donatorët në raport me të hyrat vjetore

Nga intervistat që KCSF i ka bërë me donatorë të shoqërisë civile, del që donatorët kanë mënyra dhe mekanizma të ndryshëm për t’i konsultuar OShC-të vendore rreth programimit të fondeve të tyre. Megjithatë, vetëm një numër i vogël i organizatave donatore konsultojnë organizatat dhe rrjetet e reja, kurse një pjesë e donatorëve nuk i konsultojnë fare OShC-të lokale ose përdorin burime tjera të

¹³ Intervistë me Labinot Krasniqi- OJQ KOHA, 25.10.2013

informimit.¹⁴ Praktikisht, shumica e donatorëve besojnë që arrijnë t’i marrin parasysht nevojat dhe prioritetet lokale. Megjithatë, duket që mënyrat dhe kuptimi i konsultimeve dallojnë nga donatori në donator. Disa prej tyre bazohen kryesisht në informatat dhe kontaktet e stafit të tyre ose “njohurisë kolektive” rreth situatës në terren; disa të tjerë kanë procese formale të konsultimit ku përfshihen hisedarët lokal, ndërsa donatorë tjerë zhvillojnë konsultime jo-formale me grupe më të vogla të organizatave partnere. Mënyrë tjetër mjaft e përhapur për t’i marrë parasysht nevojat lokale del të jetë edhe Raporti i Progresit të Komisionit Europian, dokument ky që shfrytëzohet gjërësisht nga organizatat donatore për t’a përcaktuar agjenden e tyre të fondeve në Kosovë.

Një element tjetër me rëndësi në programimin e fondeve është pozicionimi i atyre që marrin vendime për programim të fondeve. Edhe pse kornizat e përgjithshme të asistencës përcaktohen në vendet prej nga këta donatorë vijnë, zyrat lokale kanë mjaft hapësirë dhe fleksibilitet në përshtatjen e këtyre kornizave ndaj dinamikave të vendit. Pikërisht kjo është ajo hapësirë të cilën OShC-të mund dhe duhet ta shfrytëzojnë për të ndikuar donatorët në programimin e fondeve të tyre.

Mund të interpretohet edhe si...

Donatorët kanë dyer të hapura për OShC-të vendore (sidomos ato më të mëdhatë) që të ndikojnë në programimin e fondeve të tyre. Varet nga kapacitetet dhe angazhimi i OShC-ve vendore se sa arrijnë t’i shfrytëzojnë këto mundësi për ta ndikuar programimin e fondeve të donatorëve. Përderisa organizatat e mëdha kanë mundësi të ndikimit në programimin e fondeve të donatorëve, organizatat e vogla dhe ato lokale këtë mundësi e kanë shumë të kufizuar. Një problem shtesë për to është gjuha angleze e përdorur në dokumentacionin për aplikim, e që paraqet një problem konstant për organizatat e vogla, të cilat nuk arrijnë t’i kuptojnë dhe zbërthejnë si duhet procedurat e aplikimit.

Fondet e BE-së për shoqëri civile

Duke qenë që Kosova synon integrimin në Bashkimin Europian dhe bazuar edhe në përvojat e shteteve tjera të cilat kanë kaluar nëpër këtë proces, pritet që në një të ardhme të afërt fondet e BE-së të shndërrohen në fondet kryesore për shoqërinë civile në Kosovë. Për këtë arsye, studimi ka trajtuar ndaras fondet e BE-së për shoqëri civile, me qëllim që të shihet nëse këto fonde kanë një shtrirje të gjërë në mesin e shoqërisë civile në Kosovë dhe të evidentohen sfidat kryesore në absorbimin e këtyre fondeve.

Rezultatet tregojnë që përqindja e organizatave që kanë përfituar fonde të BE-së është në rritje. Derisa në vitin 2010 vetëm 20.6% të organizatave të anketuara kanë deklaruar që kanë përfituar fonde të BE-së, kjo përqindje tanimë ka arritur në 40%. Megjithatë një pjesë e madhe e organizatave përfituese të fondeve të BE-së këtë e kanë arritur duke qenë organizata partnere e jo organizata udhëheqëse në projekte të ndryshme.




Figura 26: Organizatat që kanë përfituar fonde nga BE-ja

Një nga arsyet e përmendura gjatë intervistave të thelluara për rritjen e

¹⁴ KCSF-Queen Mary, Universiteti i Londrës, Strategjitë dhe praktikat e qëndrueshme të donatorëve për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë (studim i papublikuar si i veçantë)

numrit të organizatave përfituese del të jetë politika e re e Zyres së Bashkimit Europian në Kosovë për fondet e IPA-s gjatë viteve 2012-2013, e cila i ka kushtëzuar organizatat aplikuese që të përfshijnë si organizata partnere ose t'i rigrantojnë një pjesë të fondeve për organizata më të vogla dhe nga rajonet e ndryshme të Kosovës. Gjithashtu, arsye tjetër e përmendur është që ky numër është rritur gjatë vitit 2012, ku një numër i konsiderueshëm i OShC-ve kosovare janë partnere të projekteve rajonale të financuara nga Bashkimi Europian, edhe pse në kuadër të projekteve rajonale Kosova mbetet vendi me më së paku organizata të përfshira.

Megjithatë, pjesa më e madhe e organizatave të shoqërisë civile (60%) nuk kanë përfituar asnjëherë nga fondet e BE-së, ndërsa 42.62% prej atyre që nuk kanë përfituar as që kanë aplikuar ndonjëherë. Kur këto organizata janë pyetur lidhur me arsyet kryesore për këtë, shumica e tyre (62.3%) e kanë përmendur problemin e bashkëfinancimit si një nga arsyet kryesore që u'a pamundëson që të përfitojnë nga këto fonde, ndërsa disa prej tyre e kanë përmendur mungesën e informatave për procedura të aplikimit si problem të rëndësishëm (26.23%). Madje, disa të intervistuar kanë thënë që kjo shpesh herë i detyron organizatat që të angazhojnë konsulentë profesional për t'ua shkruar projektet për BE, ndërsa zbatimin e këtyre projekteve e bën vet organizata. Normalisht, kjo qasje e angazhimit të konsulentëve për shkrim të projekt-propozimeve nuk preferohet nga të gjitha organizatat. Disa prej tyre theksojnë që konsulenti asnjëherë nuk arrin ta kuptojë qasjen dhe problematikën e projektit dhe kështu e vështirëson zbatimin e projekteve që mund të financohen.

OShC-të në Kosovë, procedurat dhe format e aplikimit për fonde të BE-së i konsiderojnë të vështira dhe që marrin shumë kohë, por ka perceptime edhe të vlerësimit arbitrar, bazuar edhe në ndikimet tjera jashtë kriterëve zyrtarë dhe relevante. Pavarësisht të gjithave, është shumë e qartë që një numër i madh i OShC-ve kosovare të cilat megjithatë mund të konsiderohen si të zhvilluara, ende kanë vështirësi të mëdha që të aplikojnë dhe përfitojnë fonde nga BE-së, përkundër shumë trajnimeve që janë mbajtur në këtë temë.

Mund të interpretohet edhe si...

Duke marrë parasysh faktin se edhe një numër i konsiderueshëm i organizatave të konsoliduara dhe që menaxhojnë me fonde të mëdha nga donatorët tjerë kanë vështirësi për të aplikuar dhe nuk arrijnë që të përfitojnë fonde nga BE, procedurat e aplikimit të fondeve të BE-së mund të vlerësohen të vështira, sikurse që edhe informimi dhe ngritja e kapaciteteve për këto procedura i pamjaftueshëm.

Fondet vendore

Edhe pse shoqëria civile në Kosovë vazhdon që donatorët ndërkombëtarë ti ketë burim kryesor të financimit, rezultatet e studimit tregojnë që përqindja e fondeve nga buxheti i Republikës së Kosovës në kuadër të burimeve të financimit për OShC-është në rritje. Derisa në vitet 2011 fondet qeveritare (qendrore dhe lokale) kanë marrë pjesë me 8.84%, tashmë institucionet lokale dhe qendrore sigurojnë 20.5% të burimeve të financimit të shoqërisë civile në Kosovë.




Figura 27: Organizatat që kanë përfituar fonde nga buxheti i Republikës së Kosovës

Gjithashtu, edhe përqindja e organizatave që përfitojnë nga fondet shtetërore është mjaft e lartë, ku gati se gjysma e organizatave të anketuara (44%) kanë deklaruar që kanë përfituar fonde shtetërore gjatë 3 viteve të fundit.

Studimi tregon që shumat të cilat institucionet e ndryshme shtetërore i ndajnë për organizatat e shoqërisë civile janë zakonisht më të vogla se 10,000 EUR, ndërsa në disa raste ato arrijnë edhe deri në 25,000 EUR. Nga të gjitha organizatat e anketuara, është deklaruar vetëm një rast kur një organizatë ka përfituar fonde deri në 50,000 EUR.




Figura 28: Shumat që OShC-të kanë përfituar nga fondet e buxhetit të Republikës së Kosovës

Trendi i financimit nga fondet shtetërore anon në drejtim të organizatave më të vogla që veprojnë në nivel lokal, e që financohen kryesisht nga fondet që jepen nga komunat përkatëse. Shumica e këtyre organizatave qarkullimin vjetor nuk e kanë mbi 10,000 EUR. Madje, ka organizata të cilat nuk kanë aspak fonde nga donatorët e huaj por funksionojnë vetëm bazuar në fonde të vogla, kryesisht komunale.

Në anën tjetër, shumë pak organizata që kanë qarkullim vjetor më të madh ose që veprojnë në nivel kombëtar janë përfitues të fondeve nga buxheti i Republikës së Kosovës. Përkundrazi, ato funksionojnë kryesisht ose tërësisht me fonde nga donatorët ndërkombëtarë.

Duke qenë që një nga arsyet e hezitimit për të marrë fonde shtetërore përmendet edhe mungesa e mekanizmave të duhura për fondet shtetërore, e që nuk e garantojnë ruajtjen e pavarësisë së veprimit, ky studim ka analizuar më thellë mënyrën se si fondet shtetërore ndahen për organizatat e shoqërisë civile.

Korniza ligjore e aplikueshme në Kosovë nuk parasheh ndonjë mekanizëm të veçantë për dhënie e fondeve për OShC, ndërsa procedurat e prokurimit publik që janë të vetmet të aplikueshme, nuk janë aspak të përshtatshme për natyrën e punës së sektorit të shoqërisë civile. Aktualisht, nuk ka ndonjë procedurë dhe mekanizëm të definuar se si institucionet e ndryshme publike i përcaktojnë fushat për financim, si i përzgjedhin përfituesit, sikurse që nuk dihet mënyra se si këta përfitues

raportojnë, mbikëqyren ose vlerësohen. Kjo mungesë e mekanizmave bën që institucionet e ndryshme të ndajnë fonde publike në baza *ad-hoc*, kryesisht bazuar në kërkesat që vijnë nga organizatat e ndryshme.

Këto fonde nuk janë të planifikuara përbrenda buxhetit shtetëror, ndërsa në buxhetin e vitit 2014 janë identifikuar vetëm katër raste të planifikimit specifik për përkrahje të projekteve të OShC-ve në nivelin qendror/lokal. Sipas buxhetit të vitit 2014, OJQ-të në komunën e Rahovecit do të përkrahen me 8,000 EUR për çështje sociale dhe 15,000 EUR për projekte të zhvillimit rural; në Istog një linjë buxhetore prej 15,000 është dedikuar për pjesëmarrje në projekte kapitale të OJQ-ve, komunitetit dhe donatorëve, derisa projektet lokale të OJQ-ve në Kamenicë do të përkrahen me 25,000 EUR.¹⁵ Deri më tani janë Ministritë ato që përcaktojnë qëllimet e dhënies së fondeve për OShC-të. Qeveria ende nuk ka një listë gjithëpërshirëse të OShC-ve përfituese, të fondeve të cilat janë ndarë si dhe pagesave që janë kryer. Në disa raste të dhënat mbi numrin e OShC-ve përfituese mund të mirren veç e veç në ministri/institucione, por me shumë vështirësi. Zyrtarët nga Ministria e Financave të intervistuar për këtë studim nuk ishin në gjendje të na siguronin të dhëna për shumën e fondeve të shpërndara te OShC-të. Përveç kësaj, si përgjigje në kërkesën zyrtare për informata për këtë çështje, Ministria e Financave është përgjigjur se Ligji për buxhetin nuk ka shpërndarje të drejtpërdrejta apo linjë të veçantë buxhetore për organizatat joqeveritare. Kjo konfirmon se financimi është i paparashikueshëm dhe se është e pamundshme të identifikohet shuma e fondeve publike të zotuar apo të ndara për OShC. Gjithashtu, Ligji 04/L- 080 për lojërat e fatit siguron mundësinë e drejtimit të një pjese të fondeve nga Lotaria e Kosovës te kategoritë e ndryshme sociale, çështje të të drejtave të njeriut, kulturë dhe sport. Detajet e transferimeve të tilla do të duhej të përcaktohen përmes një udhëzimi administrativ, mirëpo një udhëzim i tillë nuk është hartuar ende dhe nuk ka raporte se fonde të tilla janë mbledhur apo shpërndarë.

Sa i përket procedurave të aplikimit për përkrahje nga fondet publike (financiare apo në formë të asetëve), ato ende nuk janë të definuara mirë. Fusha e vetme ku ekzistojnë disa procedura të përcaktuara është kontraktimi i shërbimeve sociale dhe familjare, mirëpo edhe në këtë fushë ende mbetet të papërcaktuara specifikat e kontraktimit, mbikëqyrjes dhe raportimit. Shpesh, organizatat apo individët u drejtohen insitucioneve të nivelit qendror apo lokal me kërkesë direkte për përkrahje të iniciativës /projektit të tyre. Sipas pjesës më të madhe të intervistuarve, sukcesi apo mos-suksesi për të marrë këtë përkrahje, jo rrallë herë varet nga relacionet/afërsia e këtyre organizatave/individëve që kanë me përfaqësuesit e këtyre institucioneve.

Kjo mënyrë e funksionimit, kërkon më shumë angazhim të OShC-ve por edhe lë më shumë hapësirë për keqkuptime apo keqpërdorime nga palët tjera. Ka raste kur idea apo qëllimi i mirë i projektit përkrahet pa hezitim nga të gjithë. Një rast i tillë është projekti 'ATOM' në kuadër të organizatës ENCOMPASS, i cili ka për qëllim identifikimin dhe përkrahjen e personave me intelegjencë të jashtëzakonshme. Në vitin 2012, kjo organizatë me vet-iniciativë i është drejtuar institucioneve të ndryshme si në nivelin qendror poashtu në atë lokal (Zyrës së Kryeministri, Komunës së Prishtinës, Suharekës, Drenasit, Mitrovicës etj) për përkrahje financiare dhe në asete. Me këtë rast, organizata ka dorëzuar dosjen complete të organizatës, përfshirë këtu statutin, certifikatën e regjistrimit, raportet e auditimit etj. Pas shqyrtimit të kërkesës direkte të kësaj organizate, me vendim të ZKM-së dhe ekzekutuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, projektit i është ndarë shuma prej 50.000 EURO. Ndërsa në nivelin komunal, vendimet për përkrahje të kësaj organizate janë marrë nga Kryetarët e Komunave, ndërsa ekzekutimi i vendimeve është bërë nga linjat e ndryshme buxhetore. Në komunën e Prishtinës ekzekutimi i vendimit është bërë nga linja buxhetore

¹⁵ Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2014; Financimi i investimeve kapitale 2013-2015, <http://mf.rks-gov.net/en-us/ministriaefinancave/buxhetiirepublikessekosoves/buxhetiinqendrorre.aspx>,

‘Subvencionimi i Projekteve’ ndërsa në komunën e Ferizajit dhe Suharekës nga linja buxhetore (subvencione) e kryetarit të komunës, ndërsa në Drenas është bërë nga Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport.

Një rast tjetër është organizata Down Syndrome Kosova (DSK) e cila ka përfituar nga fondet publike një shumë simbolike. Edhe në këtë rast kërkesa është bërë nga vet DSK-ja. Kjo organizatë vetëm në një rast ka aplikuar në thirrje publike të bërë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ku iu është dashur të plotësojnë një aplikacion standard. Në këtë rast DSK-ja është përzgjedhur dhe ka përfituar nga ky fond nga 300 EURO në muaj, mirëpo pas një kohe ky fond është ndërprerë. Mirëpo kjo organizatë është përkrahur edhe nga komunat e ndryshme (Ferizaj, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë) të cilat u kanë ofruar zyre për shfrytëzim.

Sipas të Minsitrisë së Financave, fondet për shoqëri civile kryesisht mbulohen nga linjat buxhetore ‘Subvencione/Transfere’, ndërsa për aplikim për fonde, zbatohen procedurat dhe kriteret e prokurimit publik si dhe menaxhimit të fondeve publike. Zbatimi i këtyre kriterëve kontrollohet nga organet brenda ministrive përkatëse (Zyra e Prokurimit, Zyra e Buxhetit dhe Financave, Zyra Certifikuese). Sipas Ministrisë së Financave, raportimet e OJQ-ve përfituese bëhen në përputhje me Ligjin për prokurim publik (raporte narrative dhe financiare), e në disa raste raportet mund të bëhen sipas kërkesës.¹⁶ Megjithatë, po të analizohet Ligji për Prokurim Publik, kriteret dhe procedurat nuk janë aspak në përputhje me natyrën e punës së OShC-ve, e aq më pak natyrën e granteve, duke e bërë kështu financimin e OShC-ve nga fondet shtetërore shumë problematik.

Sipas shumicës së OShC-ve të intervistuar, zyrtarët komunal e në disa raste edhe ata në nivelin qendror nuk kërkojnë raport mbi shpenzimin e mjeteve financiare që i janë dhënë një organizate të caktuar. Kështu në rastin e projektit ATOM, pavarësisht se nuk u është kërkuar raportim, ata në fund të vitit kanë dorëzuar raportet financiare dhe narrative në të dyja nivelet, si në atë lokal dhe qendror. E njëjta ka ndodhur edhe me DSK-në, të cilëve nuk u është kërkuar raport, por kanë raportuar me vetiniciativë. Sipas disa prej të intervistuarve, ka shumë raste kur OShC të sapo themeluara marrin fonde nga autoritetet komunale, dhe pastaj nuk japin asnjë llogari.

E gjithë kjo situatë shtrën nevojën urgjente për t’a rregulluar si duhet komplet ciklin e financimit publik për shoqëri civile, përfshirë programimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e tyre. Kriteret, standardet dhe procedurat e dizajnuara do të duhet të sigurojnë zbatimin transparent dhe me llogaridhënie të të gjitha fondeve për shoqëri civile që jepen nga buxheti shtetëror.

Mund të interpretohet edhe si...

Meqenëse ka një rritje simbolike të fondeve publike për organizatat e shoqërisë civile, hartimi i kriterëve dhe procedurave adekuate për programimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e tyre është një çështje urgjente.

Fondet Private

Në shumicën e vendeve europiane, donatorët privatë që ndihmojnë shoqërinë civile gëzojnë lehtësira të ndryshme fiskale, të cilat shërbejnë si nxitje për donacionet qoftë nga sektori privat ashtu edhe nga qytetarët në kapacitet individual. Edhe në Kosovë, korniza ligjore e aplikueshme i parasheh disa lehtësira fiskale për ata që dhurojnë për organizata me Status të përfitimit publik.

¹⁶ Intervistë me Qerkin Berisha, Ministria e Financave, 07.08.2013

Megjithatë, donacionet private mbesin ende një burim i ulët i financimit të aktiviteteve të shoqërisë civile në Kosovë. Vetëm 4.2% të fondeve për shoqëri civile vijnë nga donacionet prej kompanive private, ndërsa vetëm 0.4% nga donacionet individuale. Edhe numri i organizatave që përfitojnë nga sektori privat është mjaft i vogël (23%), e edhe më i vogël nga donacione të ndryshme individuale (15.15%).




Figura 29: OShC-të përfituese të donacioneve nga kompanitë private apo individët

Sipas Ligjit për Tatimin në të Ardhurat në Korporata ‘kontributet e dhëna për qëllime humanitare, shëndetësore, edukativo-arsimore, fetare, shkencore, kulturore, mbrojtje të ambientit dhe për qëllime sportive sipas këtij Ligji lejohen si shpenzime deri në maksimumin prej pesë për qind (5%) të të ardhurave të llogaritura përpara se të jetë zbritur ky kontribut bamirës’.¹⁷

Sipas një studimi të bërë nga Instituti Riinvest, ‘kjo zbritje lejohet nëse kontributi i bëhet një OJQ-je me Status të përfituesit publik apo ndonjë organizate tjetër jo komerciale që i shërben interesit publik (institucionet shëndetësore, edukativo-arsimore dhe fetare). Kjo zbritje do të thotë se kontribuesi ka të drejtë të llogarisë donacionin si shpenzim dhe të zbres shumën e fitimit të tatueshëm. Zbritja maksimale e lejuar është 5 për qind e fitimit bruto, d.m.th. nëse një institucion privat jep një donacion në vlerë deri në 5 për qind të fitimit, atëherë ky kontribut do të jetë plotësisht i zbritshëm nga tatimi. Ky trajtim vlen si për korporatat ashtu edhe për ndërmarrjet individuale biznesi’.¹⁸ Përveç tjerash, një ndër problemet themelore në aspektin ligjor është që ky lehtësim tatimor është dhënë vetëm për një numër të përzgjedhur të aktiviteteve në dobi të publikut, kështu që nuk është në përputhje me Statusin e Përfitimit Publik i cili është i caktuar në Ligjin bazë për OJQ.

Megjithatë, rezultatet e këtij studimi tregojnë që këto lehtësira potenciale nuk prodhojnë ndonjë efekt në praktikë, respektivisht nuk janë arsye për të cilat një kompani ose individ mund të vendosë që të dhurojë fonde për shoqëri civile. Edhe në ato pak raste kur organizatat përfitojnë donacione nga




Figura 30: Arsyet e kompanive private/individëve për dhënien e donacioneve (pyetje me përgjigje të shumëfishta)

¹⁷Neni 10, paragrafi 1 i Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave

¹⁸Instituti RIINVEST, Analizë e Kornizës Ligjore për Çështjet Fiskale të OJQ-ve në Kosovë, p.22, Nëntor 2012

kompanitë private, arsyet kryesore për këtë veprim dalin të jenë përkrahja për çështjen/aktivitetin e caktuar (82.61%) e kombinuar me përkrahjen për vet organizatën përfituese (52.17%), ndërsa lehtësirat fiskale duket të mos jenë arsye pse një kompani private vendos që të japë donacione. Të ngjashme janë arsyet edhe për individët të cilët vendosin që të japin donacione për aktivitete ose organizata të shoqërisë civile.

Një arsye interesante që është deklaruar për dhënien e donacioneve është ngritja e imazhit publik të kompanisë/individit dhurues. 34.78% të donacioneve nga kompanitë private dhe 13.33% të donacioneve nga individët janë dhënë për këtë arsye. Njëra nga to është kompania për prodhimin e pijeve jo-alkoolike 'Coca Cola', e cila me qëllim të ngritjes së imazhit, për çdo vit ndan donacione për organizata të ndryshme të shoqërisë civile, siç është fshati i fëmijëve jetim 'SOS Kosova'. Padyshim ka edhe kompani tjera që japin donacione të tilla për OJQ, siç është kompania Meridian apo bankat e ndryshme në Kosovë. Edhe pse ky studim nuk posedon të dhëna të detajuara rreth kësaj çështjeje, gjatë intervistave të thelluara është përmendur mundësia e ngatërimit të konceptit të donacionit me sponsorizim, ku kjo e fundit është pjesë e strategjive dhe aktiviteteve të marketingut të kompanive private. Kjo mbetet një çështje e cila duhet studiuar më në hollësi në të ardhmen.

Sipas përfaqësuesve të Administratës Tatimore të Kosovës, 'ka raste kur kompanitë/individët kërkojnë lehtësira fiskale për donacionet e tyre për organizatat me Status për përfitim publik. Kjo është e rregulluar me ligj dhe praktikohet. Për të kryer donacionin duhet të mbushet fatura në të cilën shënohen të dhënat e biznesit dhe të dhënat e organizatës përfituese (e cila zakonisht nuk verifikohet). Ky donacion pastaj zbritet nga shuma e fitimit neto në baza vjetore. Procedura e rimbursimit zgjat zakonisht 60 ditë, ndërsa kërkesa bëhet në degët e ATK-së, ku precizohet edhe lloji i tatimit për të cilin kërkohet lirimi'.¹⁹

Vullnetarizmi

Duke qenë karakteristikë e rëndësishme e shoqërisë civile, puna vullnetare ka qenë një nga çështjet e trajtuara në kuadër të këtij studimi, kryesisht duke e analizuar trendin e rritjes ose rënies së nivelit të vullnetarizmit në sektorin civil në Kosovë dhe arsyeve për këtë trend. Të dhënat e këtij studimi nga hulumtimi i popullsisë me 1,300 respondentë janë krahasuar me të dhënat e njehta nga viti 2011, si dhe janë vendosur në raport me perceptimet e vet organizatave të anketuara.

Rezultatet tregojnë që puna vullnetare në shoqërinë civile në Kosovë vazhdon të mbetet e ulët, me një trend të lehtë të rënies. Kështu, derisa në vitin 2011 puna vullnetare në lloje të ndryshme të organizatave të shoqërisë civile ka qenë 4.5%, në vitin 2013 vetëm 3.1% e qytetarëve kanë deklaruar që bëjnë punë vullnetare për ndonjë organizatë të shoqërisë civile.




Figura 31: Përqindja e qytetarëve që bëjnë punë vullnetare

Kjo konfirmohet edhe nga vet perceptimet e organizatave, të cilat mendojnë që puna vullnetare mbetet në nivel konstant (47.52%) ose është në rënie (32.67%). Vetëm një pjesë e vogël e organizatave të anketuara (19.8%) mendojnë

¹⁹ Intervistë me Isuf Zeriqi dhe Ajtene Shabani, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Gusht 2013

që puna vullnetare është në rritje. Kur organizatat që mendojnë që puna vullnetare është në rënie janë pyetur për arsyet e kësaj rënie, arsyet më të përmendura janë mungesa e përfitimeve jo-monetare dhe gjendja e vështirë ekonomike e popullsisë, e pasuar nga mungesa e njohjes së punës vullnetare me ligj. Në anën tjetër, ato pak organizata që mendojnë që puna vullnetare është në rritje, deklarojnë që arsye kryesore për këtë është ngritja e vetëdijes së popullsisë dhe imazhi i mirë i shoqërisë civile.




Figura 32: Mendimi i OShC-ve për rritjen/zvogëlimin e punës vullnetare

Përveç tjerash, ky studim ka analizuar edhe numrin e vullnetarëve të rregullt që janë të angazhuar në kuadër të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë. Nga deklaratimet e vet organizatave të anketuara, vërehet që shumica e organizatave (55.2%) kanë më pak se 5 vullnetarë të rregullt, ndërsa 16.10% prej këtyre organizatave nuk kanë asnjë vullnetar. Në anën tjetër, një numër i vogël i organizatave (5%) të anketuara deklarojnë të kenë një grup më të madh të vullnetarëve që në baza të rregullta angazhohen në punën e organizatës. Këto organizata janë kryesisht organizata rinore (si p.sh. Këshilli Rinor Kosovar ose Qendra Rinore At Lorenc Mazreku në Pejë) ose organizata humanitare (si p.sh. Caritas Kosova). Organizatat tjera që merren me çështje të demokratizimit karakterizohen me numër më të ulët të vullnetarëve të rregullt, ndërsa përjashtim bën Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) që ka një numër më të lartë të vullnetarëve për shkak të vet natyrës specifike të zhvillimit dhe punës.




Figura 33: Organizatat sipas numrit të vullnetarëve

Sa i përket vullnetarizmit, krahasur me vitet e mëhershme ende nuk kanë lëvizur shumë gjëra. Përpos Ligjit për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, nuk ka ndonjë ligj/rregullore tjetër që rregullon në mënyrë të detajuar vullnetarizmin edhe për grupmoshat ose fushat tjera. Ngjashëm, ende nuk ka një qendër e cila do të promovonte vullnetarizmin, apo ndonjë regjistër ku janë të regjistruar të gjithë vullnetarët në nivel të vendit. Megjithatë, një hap pozitiv mund të konsiderohet përfshirja e vullnetarizmit si një nga objektivat kryesore të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile.²⁰ Përderisa angazhimi institucional mbetet i ulët, shumë individë dhe OShC angazhohen apo angazhojnë vullnetarë në baza ad-hoc, si pjesë të aktiviteteve/projekteve të ndryshme. Disa nga këto organizata të cilat njihen për angazhimin e vullnetarëve janë: Dokufest, Nëna Terezë, Kryqi i Kuq i Kosovës, Qendra për Përparimin e Edukimit dhe Arsimit dhe të tjera.

²⁰ Qeveria e Kosovës-CIVIKOS, Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, 2013

Përkundër nivelit të ulët të punës vullnetare në shoqëri civile, studimi tregon që megjithatë në organizatat e shoqërisë civile ka më shumë persona që angazhohen në mënyrë vullnetare sesa të tillë që marrin paga.




Figura 34: Organizatat sipas numrit të vullnetarëve të rregullt/të punësuarve me pagë

Një rast i mirë i promovimit të punës vullnetare është 'Projekti CAP'²¹ i cili zbatohet nga një grup të rinjsh vullnetarë të Universitetit Amerikan në Kosovë. Projekti "Kosova CAP" ka për qëllim mbledhjen e mëpastaj riciklimin e kapakëve të plastikës, si burim për të blerë dhe dhuruar karroca për persona me aftësi të kufizuara në Kosovë. Projekti është i karakterit humanitar dhe ka për qëllim të ndihmojë personat me aftësi të kufizuara në vend, duke ngritur në të njëjtën kohë vetëdijen e qytetarëve rreth riciklimin. Projekti ka gjetur përkrahje të madhe tek shumë qytetarë brenda dhe jashtë Kosovës, si në aspektin e mbledhjes së kapakëve, poashtu edhe transportimit të tyre për në Turqi. Megjithatë, pavarësisht funksionimit të mirë të kësaj iniciative, diskutabile mbetet qëndrueshmëria e saj. Vullnetarët e angazhuar nuk paguhën për punën e bërë, dhe një pjesë e tyre tashmë janë angazhuar në punë të rregullta, çka e vështirëson qëndrueshmërinë e projektit. Sipas disa vullnetarëve, në mungesë të ndonjë përkrahje të vazhdueshme nga shteti, kjo iniciativë ndonjëse tani për tani e suskeshme, në një të ardhme rrezikon të shuhet.

²¹Projekti "Kosova CAP" është një vazhdimësi e projektit të ngjashëm që është realizuar me sukses në Turqi, i iniciuar nga studenti kosovar Kushtrim Ahmeti.

3.4 NDIKIMI I PERCEPTUAR

Motivi fillestar i njerëzve për tu mbledhur, dhe qëllimi i fundit i shoqërisë civile – në kuptimin e gjerë – është përmirësimi i kushteve jetësore në komunitetin dhe shoqërinë e tyre. Megjithatë, matja e një ndikimi të tillë në kushte konkrete është gati se e pamundur dhe varet nga shumë faktorë. Për këtë arsye metodologjia e këtij studimi përqipet ta masë vetëm **Ndikimin e Perceptuar**, më shumë se sa vet ndikimin.

Reagueshmëria

Fillimisht, studimi ka synuar që të analizojë çështjen se sa shoqëria civile reagon ndaj problemeve dhe brengave kryesore të qytetarëve. Të gjitha studimet e viteve të fundit konfirmojnë që çështjet e ndërlidhura me zhvillimin ekonomik (papunësia, varfëria, çështjet sociale, etj.) dhe sundimin e ligjit (korrupsioni, drejtësia dhe sistemi gjyqësor, të drejtat e njeriut, etj.) vazhdojnë të mbesin brenga kryesore të qytetarëve të Kosovës. Për ndikimin e shoqërisë civile në këto dy fusha janë matur perceptimet e vet organizatave të anketuara rreth ndikimit të sektorit në përgjithësi.

Rezultatet tregojnë që ndikimi i shoqërisë civile në zhvillimin ekonomik dhe sundimin e ligjit është i kufizuar. Konkretisht, shumica e organizatave të anketuara mendojnë që ndikimi i shoqërisë civile në zhvillimin ekonomik është i kufizuar (57.73%) apo nuk ka pasur fare ndikim (18.56%). Perceptim i ngjashëm është edhe për fushën e sundimit të ligjit, ku 53.61% të organizatave të anketuara mendojnë që ka pasur ndikim të kufizuar dhe 12.37% që nuk ka pasur fare ndikim. Megjithatë, vërehet një ndryshim i lehtë në favor të sundimit të ligjit, ku 34.02% të organizatave të anketuara mendojnë që shoqëria civile ka pasur nivel mestar ose të lartë të ndikimit, në krahasim me 22.71% që e ndajnë këtë mendim për zhvillimin ekonomik. Këto të dhëna janë gati se identike me matjen e perceptimit nga viti 2011, përfshirë edhe dallimet në mes të zhvillimit ekonomik dhe sundimit të ligjit²².




Figura 35: Perceptimi mbi ndikim e shoqërisë civile në zhvillim ekonomik/sundim të ligjit

Disa nga arsyet e mundshme për këtë ndikim të kufizuar, e të cilat janë përmendur nga vet organizatat e shoqërisë civile, kanë të bëjnë me mjetet e kufizuara të cilat shoqëria civile i ka në dispozicion për të zgjidhur probleme të ndryshme ligjore dhe ekonomike. Gjithashtu, çështjet e zhvillimit ekonomik dhe sundimi i ligjit janë shumë komplekse dhe përmirësimi i gjendjes në këto fusha varet nga shumë aktorë dhe faktorë, shumica nga të cilat janë jashtë kontrollit të shoqërisë civile.

Në anën tjetër, studimi ka matur edhe perceptimin e ndikimit të shoqërisë civile në fusha tjera të cilat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të angazhimit të shoqërisë civile në përgjithësi. Rezultatet

²² KCSF-CIVICUS, Indeksi i Shoqërisë Civile, Qeverisje më e mirë për një ndikim më të madh (2011), Figura No.10

tregojnë që ndikimi më i madh i shoqërisë civile perceptohet të jetë në fushën e demokratizimit, ku 40% e organizatave të anketuara mendojnë që shoqëria civile ka pasur më së shumti ndikim, pasuar nga barazia gjinore (16%) dhe përkrahja për komunitetet e varfëra dhe grupet e marginalizuara (13%). Në këto fusha, pjesa më e madhe e organizatave të anketuara vlerësojnë që shoqëria civile ka pasur ndikim të ndjeshëm (64.29%) apo të lartë (10.20%).




Figura 36: Fushat e ndikuara më së shumti nga shoqëria civile, sipas perceptimeve të OShC-ve dhe perceptimeve të jashtme

Perceptim të ngjashëm kanë edhe aktorët e fushave tjera jashtë shoqërisë civile, të cilët mendojnë që shoqëria civile ka pasur më së tepërmi ndikim në demokratizim (40%) dhe barazi gjinore (30%).

Avokimi

Një pjesë e rëndësishme e punës dhe angazhimit të shoqërisë civile është e drejtuar ndaj institucioneve publike, duke avokuar për politika dhe ligje të ndryshme apo duke kontribuar në procese të ndryshme të vendim-marrjes. Ky studim ka trajtuar disa nivele të këtij ndërveprimi, duke filluar nga komunikimi në mes të dy sektorëve, qasja në informata dhe dokumente publike, si dhe kontributi dhe ndikimi i shoqërisë civile në hartimin e politikave, ligjeve apo rregulloreve komunale.

Komunikimi me sektorit civil dhe institucioneve publike, e që nënkupton shkëmbim informatash, takime, aktivitete të përbashkëta, sipas rezultateve të studimit del të jetë në një nivel relativisht të lartë. Nga organizatat e anketuara, shumica prej tyre komunikimin me institucionet relevante për punën e tyre e kanë relativisht të shpeshtë (54%) ose shumë të shpeshtë (13%). Grupi tjetër i organizatave të anketuara kanë deklaruar komunikim shumë të rrallë (28%) ose që nuk kanë komunikim fare (5%).




Figura 37: Komunikimi i OShC-ve me institucione publike

Informimi në kohë dhe në formë adekuate mbi punën e institucioneve publike është parakusht i çfarëdo bashkëpunimi në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve publike, si dhe element shumë i rëndësishëm i nismave për avokim nga organizatat e shoqërisë civile. Ky studim ka analizuar qasjen e OShC-ve në informata dhe dokumente publike, kërkesat për qasje dhe si trajtohen këto kërkesa, si dhe nëse ka ndonjë grup të shoqërisë civile që ka qasje më të kufizuar ose privilegjuar në informata dhe dokumente publike. Rezultatet e këtij studimi tregojnë që më shumë se gjysma e organizatave të anketuara (58.2%) kanë qasje të kufizuar ose nuk kanë qasje në informata dhe dokumente publike, ndërsa pjesa tjetër e organizatave vlerësojnë që kanë qasje të mjaftueshme (36.7%) ose të pakufizuar (5.1%).




Figura 38: Qasja e OShC-ve në informata publike

Përderisa pjesa e konsiderueshme e informatave mbi planet dhe punën e institucioneve publike duhet të jenë të qasshme automatikisht dhe të mos varen nga kërkesat e palëve të jashtme, megjithatë është brengosëse një përqindje e lartë e organizatave të cilat nuk e shfrytëzojnë të drejtën e kërkesës për qasje. Konkretisht, kur janë pyetur për arsyet e mungesës së qasjes në informata, një gjetje interesante tregon që një pjesë e konsiderueshme e organizatave të anketuara nuk kanë bërë asnjëherë kërkesë për qasje në informata (37.11%). Pjesa tjetër e organizatave që e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë ndahet në grupe për afërsisht të barabarta: 20.62% të organizatave i'u është refuzuar kërkesa ose i'u është vonuar përgjigja, 20.62% të organizatave i'u janë refuzuar disa kërkesa dhe 21.65% të organizatave nuk i'u është refuzuar asnjë kërkesë për qasje në informata dhe dokumente publike.




Figura 39: Aprovimi/ Refuzimi i kërkesave për qasje në informata

Përveç të dhënave të mbledhura për nevoja të këtij studimi, Zyra për Komunikimin me Publikun e Zyrës së Kryeministrit ka publikuar edhe raportin vjetor qeveritar për zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike për vitin 2012. Disa nga problemet kyqe që evidentohen në këtë raport, e që e ndikojnë edhe shoqërinë civile, kanë të bëjnë me mungesën e vendimeve me shkrim lidhur me lejimin e qasjes apo refuzimit të qasjes në dokumentin e kërkuar, si dhe përqindjen shumë të ulët

(28%) të refuzimeve me shkrim. Edhe pse ky raport synon të jetë gjithëpërfshirës dhe të përfshijë informata nga të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës, një problem tjetër që identifikohet nga ky raport qeveritar është mungesa e raportimit rreth realizimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, sidomos nga agjencitë e pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës. Gjithashtu, ky raport evidenton që shumica e kërkesave për qasje në dokumente publike vijnë nga gazetarët, ndërsa shoqëria civile kërkon që ta ushtrojë këtë të drejtë më së shumti në nivelin lokal.²³

Mund të interpretohet edhe si...

Mungesa e akteve nënligjore, mungesa e një dokumenti që bën kalsifikimin e duhur të dokumenteve, refuzimi i përgjigjes nëpërmjet heshtjes apo mos-kthimi i përgjigjeve me shkrim në afatin e paraparë, vështirëson qasjen në dokumente publike. E fundit, mos aplikimi i sanksioneve të parapara ligjore për zyrtarët që refuzojnë qasjen në informata/dokumente publike, vetëm se e favorizon mbylljen e institucioneve ndaj qytetarëve dhe shoqërisë civile.

Në pyetjen se a janë aktive në procesin e hartimit të dokumenteve të ndryshme publike (ligje, politika, akte nënligjore, rregullore komunale, etj.), shumica e organizatave të anketuara (63.64%) deklarojnë që gjatë 3 viteve të fundit janë angazhuar në ndonjë proces të hartimit të dokumenteve publike. Duke i analizuar nivelet e këtij angazhimi, rezultatet tregojnë që sa më i vogël të jetë territori/hapësira e mbuluar nga një organizatë, aq më e ulët është përfshirja e tyre në hartim të dokumenteve publike. P.sh. organizatat që janë aktive vetëm në një fshat/qytezë/komunë, janë më pak aktive në procesin e hartimit të dokumenteve publike. 69.23% prej këtyre organizatave kanë deklaruar që gjatë 3 viteve të fundit nuk janë




Figura 40: Angazhimi i OShC-ve në hartim të politikave

²³ Raport gjithëpërfshirësi institucioneve publike për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike për vitin 2012 - http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Raporti_Shqipp.pdf

angazhuar asnjëherë në hartim të dokumenteve publike, ndërsa niveli i angazhimit rritet te organizatat tjera që punën e tyre e zhvillojnë në disa komuna ose në nivel kombëtar.

Disa nga fushat ku organizatat deklarojnë të kenë qenë më së shumti të angazhuara në hartim të ligjeve dhe politikave janë demokratizimi (26.98%), përkrahja e komuniteteve të varfra dhe të marginalizuara (12.7%), arsimi (11.11%) dhe barazia gjinore e ambienti (secila me nga 7.94%). Nga jashtë, duket që angazhimi i shoqërisë civile në fushën e barazisë gjinore ka qenë më i dukshmi, pasuar me fushën e luftës kundër korrupsionit. Disa të intervistuar këtë dukshmëri më të madhe të këtyre fushave në opinionin publik e lidhin me një qasje më proaktive të publicitetit të aktiviteteve të këtyre organizatave në raport me organizatat e fushave tjera, sikurse edhe me vet ndjeshmërinë më të madhe të temave në rrethanat aktuale në Kosovë, siç është lufta kundër korrupsionit.




Figura 41: Fushat ku OShC-të kanë qenë aktive, sipas perceptimeve të OShC-ve dhe perceptimeve të jashtme

Megjithatë, edhe brenda këtyre dy fushave ku perceptimet e jashtme e shohin shoqërinë civile si më aktive, ndikimi i këtij aktiviteti ndryshon. Aktorët jashtë shoqërisë civile mendojnë që në hartimin e politikave/ligjeve në fushën e barazisë gjinore shoqëria civile ka pasur rezultate të mira dhe ka shkaktuar ndryshim pozitiv. Në anën tjetër, në hartimin e politikave/ligjeve që e luftojnë korrupsionin ndikimi ka qenë shumë i kufizuar, dhe këtë kryesisht për shkak që politikanët/vendim-

marrësit nuk kanë dëgjuar ose nuk kanë marrë parasysh kontributet e shoqërisë civile.




Figura 42: Perceptimet e jashtme për ndikimin e OShC-ve në hartim të politikave




Figura 43: OShC-të e ftuara për konsultime nga autoritete publike

Duke analizuar nivelin e dytë të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në vendim-marrje, rezultatet e studimit tregojnë që një pjesë e konsiderueshme e organizatave të shoqërisë civile kohë pas kohe pranojnë ftesa për konsultime nga autoritetet publike, ndërsa pjesa tjetër e organizatave u takon dy ekstremeve tjera: 29.29 % deklarojnë që janë ftuar rregullisht (kur ka pasur zhvillime në fusha të tyre të punës), ndërsa 24.24% deklarojnë që nuk janë ftuar asnjëherë ose janë ftuar shumë rrallë.

Sa i përket ftesave nga autoritetet publike, një zhvillim i kohëve të fundit që mund të ketë ndikuar në këtë rezultat është marrëveshja në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Platformës CiviKos, e cila ka ndikuar që shumica e projekt-ligjeve dhe akteve nënligjore që draftohen nga ministrinë e ndryshme të shpërndahen për konsultim me shkrim të organizatave të shoqërisë civile, nëpërmjet kësaj

Në vitin 2012, Parlamenti i Kosovës ka miratuar ligjin e sponsoruar nga Ministria e Financave dhe Banka Qendrore e Kosovës, i cili lejonte transformimin e OJQ-ve mikrofinanciare në kompani private, duke mundësuar transferim të drejtpërdrejtë të pronësisë të udhëheqësit e atyre OJQ-ve. Pas reagimit të koalicionit të OShC-ve të cilat e kundërshtuan këtë transformim, në vitin 2013 Gjykata Kushtetuese deklaroi se të gjitha dispozitat e ndërlidhura me transformimin janë jokushtetuese.

platforme. Kjo mund të konsiderohet vetëm një hap i vogël pozitiv, por asesi i mjaftueshëm, për vet faktin që ka mjaft organizata që nuk janë pjesë e Platformës CiviKos dhe rrjedhimisht janë të përjashtuara nga ky njoftim. Për më tepër, gjatë viteve të fundit është vërejtur edhe një sfidë tjetër në raport

me procesin e konsultimit publik, e që është përjashtimi i plotë i disa ligjeve shumë të rëndësishme për të cilat ka interes politik apo ekonomik. Vetëm sa për ilustrim, dy nga ligjet më të kontestuara nga shoqëria civile, e që kanë qenë Ligji për Banka dhe Mikrofinanca dhe Ligji për Amnisti, asnjëherë nuk kanë kaluar nëpër procesin e konsultimit publik në nivel qeveritar. Rasti i Ligjit për Banka dhe Mikrofinanca ka kaluar nëpër gjithë fazën e Qeverisë pa asnjë informatë ose përfshirje të shoqërisë civile, ndërsa në nivelin e Kuvendit kërkesat e shoqërisë civile janë injoruar dhe Kuvendi ka miratuar ligjin me të gjitha nenet e kontestuara.

Vetëm ftesa ose pjesëmarrja në konsultim nuk nënkupton që organizatave të shoqërisë civile ndikojnë patjetër në përmbajtjen e dokumenteve që hartohen nga institucionet publike. Shumica e organizatave të anketuara vlerësojnë që ndikimi i tyre në këtë proces ka qenë i kufizuar (59.79%) ose




Figura 44: Ndikimi i OSHC-ve në hartim të dokumenteve publike

nuk ka pasur fare ndikim (7.22%). Një pjesë më e vogël prej tyre vlerësojnë që kanë pasur ndikim të ndjeshëm (29.9%), ndërsa shumë pak organizata vlerësojnë që kanë pasur ndikim të lartë (3.09%). Ky ndikim i lartë jo patjetër nënkupton hapjen e vendim-marrësve, mirëpo në shumë raste ka të bëjë me faktin që në tema specifike ekspertiza, pozicioni ose kontributi i shoqërisë civile dominon mbi punën e shërbyesëve civil, duke bërë që politika/ligje/strategji të caktuara në realitet të hartohen kryesisht bazuar në kontributet e shoqërisë civile.

3.5 AMBIENTI I JASHTËM

Në kuadër të kapitullit ‘Ambienti i jashtëm’ janë analizuar disa nga parametrat e fundit në fushën e zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe atë politik, e të cilat ndikojnë direkt ose indirekt në punën e shoqërisë civile në Kosovë.

Konteksti socio-ekonomik

Sipas regjistrimi të fundit të popullsisë (2012), Kosova ka 1,815,606 banorë, dhe ende mbetet një ndër vendet më të varfëra në Europë, me BPV prej vetëm 2,721 EUR për kokë banori.²⁴ Niveli i papunësisë mbetet i lartë (45%), dhe konsiderohet si njëri prej faktorëve kryesor që shtyn një numër të konsiderueshëm të popullsisë të synojë migrimin jashtë vendit, si dhe e nxit ekonominë joformale. Ekonomia bazohet kryesisht në sektorin e shërbimeve (64.5%), pasuar nga industria (26%), prodhimi (16%) dhe bujqësia (12.9%).²⁵ Problemet kryesore të qytetarëve në Kosovë mbesin papunësia (46%), mungesa e rritjes ekonomike (24%), korrupsioni (14%) dhe varfëria (5%).²⁶

Ndërsa, sipas raportit “EU Business”, ekonomia e vendit edhe më tutje mbetet e varur në masë të madhe nga remitencat dhe përkrahja financiare dhe teknike e komunitetit ndërkombëtar. Remitencat nga Gjermania dhe Zvicra vlerësohen të jenë 18% e Bruto Produktit Vendor, ndërsa përkrahja financiare nga faktori ndërkombëtar është 10% e GDP-së.²⁷

Kur bëhet fjalë për transparencë financiare, institucionet publike nuk qëndrojnë mirë sa i përket raportimit financiar.²⁸ Problematik konsiderohet mënyra e hartimit të buxhetit të Kosovës, e po ashtu edhe mënyra e shpenzimit dhe raportimit të shpenzimeve. Si ilustrim, Ministria e Financave ka reduktuar mënyrën e raportimit në baza tre mujore dhe vjetore, fakt që prej organizatave të shoqërisë civile konsiderohet si ulje e nivelit të transparencës mbi mënyrën e shpenzimit të parasë publike. Për shembull, nga 19 Ministri sa ka Kosova, vetëm Ministria e Drejtësisë publikon në baza të rregullta për mënyrën e shpenzimit të parasë publike.

Në anën tjetër, përveç komunës së Malishevës dhe Prizrenit që bëjnë raportime të rregullta për mënyrën e shpenzimit të parasë publike, komunat tjera bëjnë përshkrim të thjeshtë të buxhetit të institucioni. Sipas raportit të Institutit GAP, në shumicën e komunave ndarjet buxhetore shpesh janë njëjtë të paqarta, ndërsa shumat e mëdha buxhetore të ndara për financimin e projekteve raportohen si “Bashkëfinancim me Donatorët”, pa ndonjë spjegim adekuat mbi mënyrën e financimit të këtyre projekteve. Kjo formë raportimi nuk lejon parashikim të qartë të investimeve të bëra nga organizatat buxhetore dhe lejon hapësirë për manipulim të buxhetit nga ata që menaxhojnë këto fonde.

Në anën tjetër, korrupsioni mbetet një sfidë e vazhdueshme për zhvillimin normal të vendit. Sipas të dhënave të publikuara në raportin e Transparency International, Kosova rradhitet në vendin e 110 nga 176 shtete gjithsej. Këshilli Kombëtar për Anti Korrupsion i themeluar në vitin 2012, duket se nuk po arrinë që të kryejë punën e vet si duhet.²⁹

²⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, <http://esk.rks-gov.net/>, shiquar me 27.11.2013

²⁵ EU Business, Kosovo: Economic Overview, <http://www.eubusiness.com/europe/kosovo/aggregator/econ>

²⁶ Hulumtimi i Qendrës për Studime të Sigurisë, Barometri Kosovar i Sigurisë, 2013

²⁷ EU Business, Kosovo: Economic Overview, <http://www.eubusiness.com/europe/kosovo/aggregator/econ>

²⁸ Raporti i Institutit GAP, Buxheti i Kosovës, Transparenca dhe Format e Raportimit Buxhetor, 2013,

[http://www.institutigap.org/documents/42354_AnalizaperbuxhetinSHQIPfinal%20\(1\).pdf](http://www.institutigap.org/documents/42354_AnalizaperbuxhetinSHQIPfinal%20(1).pdf)

²⁹ Freedom House, Kosovo Overview, <http://www.freedomhouse.org/report/freedom-world/2013/kosovo>

Zhvillimi i ulët ekonomik, varshmëria nga remitencat, papunësia e lartë, niveli i lartë i korrupsionit, si dhe mungesa e investimeve të jashtme, ambientin socio-ekonomik në të cilin vepron shoqëria civile në Kosovë nuk e bëjnë të favorshëm. Në anën tjetër niveli i ulët i përkrahjes financiare qoftë nga fondet publike apo nga kompanitë private e bën edhe më të vështirë ekzistencën dhe qëndrueshmërinë e organizatave të shoqërisë civile në vend.

Konteksti socio-politik

Kosova konsiderohet vend që karakterizohet me një dinamikë të shtuar të kontekstit të saj politik. Në shtator të vitit 2012 ka përfunduar mandati mbikqyrës i “Grupit Mbikëqyrës Ndërkombëtar”, mirëpo një numër i konsiderueshëm i organizatave ndërkombëtare, përfshirë këtu EULEX-in dhe NATO-n, mbeten akoma në Kosovë. Pavarësisht kësaj, ligjitimiteti i shtetit mbetet i kufizuar si në rajon poashtu në arenën ndërkombëtare. Deri më tani Kosova nuk është njohur nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së, ashtu sikurse edhe nga një numër i madh i vendeve anëtarë të OKB-së.

Në anën tjetër, diskutimet e nivelit të lartë në mes të Kosovës dhe Serbisë të cilat kanë filluar në tetor të vitit 2012, ende po vazhdojnë ndërsa marrëveshjet e arritura shpesh po hasin në vështirësi gjatë fazës së zbatimit. Bazuar në një marrëveshje të tillë ka ardhur deri te hartimi dhe miratimi i Ligjit për Amnisti, i cili ka zgjuar reagime të shumta të shoqërisë civile në Kosovë. Për më tepër, si pasojë e këtij dialogu, tashmë 9 komuna të Kosovës udhëhiqen nga kryetarë të cilët nuk e pranojnë Republikën e Kosovës.

Sa i përket zgjedhjeve lokale, ato patën një ecuri të mbarë përveq pjesës veriore të Mitrovicës. Megjithatë, sipas BE-së këto zgjedhje u cilësuan si të rregullta në tërë Kosovën, përveç tri qendrave në pjesën veriore ku pati incidente.³⁰ Vlerësime të ngjashme për zgjedhjet lokale të vitit 2013 u ndanë edhe nga institucionet dhe organizatat vendore.

Sipas raportit ‘Freedom House’, demokracia në Kosovë vlerësohet me 5.25 pikë, dhe klasifikohet si regjim autoritar gjysëm i konsoliduar.³¹ EULEX-i mbetet ende autoritet me fuqi ekzekutive në fushën e rendit dhe sundim të ligjit në mbarë territorin e Kosovës. Ky mision mbikqyrë doganat, policinë dhe sistemin gjyqësor, megjithatë fuqia ekzekutive e misionit të EULEX-it kryesisht ka të bëjë me rastet e krimeve të luftës, korrupsionit dhe krimit të organizuar në Kosovë.³² Pikërisht për shkak të rasteve që kanë të bëjnë me burgosjen dhe gjykimin e figurave politike të luftës, tash së voni Qeveria e Kosovës ka bërë thirrje për largim të misionit të EULEX-it nga Kosova. Si përgjigje ndaj qëndrimit të qeverisë, disa akterë nga shoqëria civile, kanë argumentuar se prania e misionit të BE-së është e domosdoshme edhe më tutje në Kosovë.³³

Kështu, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, thekson se gjyqtarët dhe prokurorët kosovarë hezitojnë të merren me vepra të rënda kriminale dhe të korrupsionit.³⁴ Përkundër pritshmërive të shoqërisë kosovare, sukcesi në zgjidhjen e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar nga EULEX ka qenë jo i kënaqshëm, dhe si rrjedhojë, shpresa e popullatës në vend ka filluar të zbehet.³⁵

³⁰ EU, Election Observation Mission. Press Release, EUEOM /2013/07,

http://www.eueom.eu/files/pressreleases/english/press-release-kosovo-05112013_en.pdf

³¹ Freedom House, <http://www.freedomhouse.org/report/nations-transit/2013/kosovo>,

³² Raporti i KIPRED, Analizë Gjithëpërfshirëse e EULEX-it: Çka më Tutje?, 2013,

http://www.kipred.org/advCms/documents/70619_Analize_Gjithperفشirëse_e_EULEX-it_Cka_me%20tutje.pdf

³³ Në kohën e publikimit të këtij studimi, rishqyrtimi i mandatit të EULEX ka qenë në proces.

³⁴ Portal i Telegrafit, Eulex, mos ik! <http://www.indeksonline.net/?FaqelD=2&LajmID=68282>

³⁵ Raporti i KIPRED, Analizë Gjithëpërfshirëse e EULEX-it: Çka më Tutje?, 2013,

http://www.kipred.org/advCms/documents/70619_Analize_Gjithperفشirëse_e_EULEX-it_Cka_me%20tutje.pdf

Sa i përket të respektimit të drejtave dhe lirive të njeriut, Kushtetuta e Kosovës mbron liritë themelore të njeriut. Megjithatë, sipas ‘Freedom House’ Kosova cilësohet si vend pjesërisht i lirë. Poashtu sipas këtij raporti gazetarët kohë pas kohe kanë vështirësi në kryerjen e detyrave të veta. Raportimet më të shpeshta janë në lidhje me ngacmimin dhe frikësimin e gazetarëve.³⁶ Sipas këtij raporti, poashtu vështirësi paraqiten në lëvizjen e lirë të minoriteve si dhe në integrimin ekonomik të të gjithë të kthyerve në territorin e Kosovës.³⁷

Sai përket kornizës ligjore për financimin dhe raportimin e partive politike, të gjeturat e raportit të “Transparency International”, sygjerojnë se ato duhet përmirësuar ende. Sipas këtij raporti, nuk ka përputhje në mes të raporteve financiare, të hyrave dhe shpenzimeve. Ndryshe nga vendet tjera (Kroaci, Serbi, Maqedoni) ku kërkohet me ligj nga partitë politike të hapin një xhirollogari bankare të ndarë që lejon monitorimin e të gjitha transakcioneve bankare në lidhje me financimin dhe shpenzimin gjatë fushatave politike, një gjë e tillë nuk vlen edhe për Kosoven. Për më shumë, gjatë vlerësimit të besueshmërisë së raportimit financiar të partive politike, përgjigjet e të anketuarve (shoqërisë civile, opinionit publik, agjencive mbikëqyrëse) kanë shënuar notën 2.2, që tregon nivel të ulët të besueshmërisë.³⁸

Lëvizjet e shpeshta politike, bisedimet Kosovë - Serbi, zbatimi jo i kënaqshëm i ligjeve, mos-marrja parasysh e ‘zërit’ të shoqërisë civile vetëm sa e ilustronë ambientin e vështirë politik në të cilin vepron shoqëria civile në Kosovë.

Konteksti socio-kulturor

Për të analizuar kontekstin socio-kulturor në të cilin vepron shoqëria civile në Kosovë, janë marrë disa të dhëna kryesore nga raportet e publikuara së fundmi.

Sa i përket besimit në institucionet e demokracisë, sipas ‘Barometrit Kosovar të Sigurisë’ (2013), kosovarët në përgjithësi kanë besim në Forcën e Sigurisë së Kosovës (78%) dhe në institucionet fetare (60%). Nivele disi më të ulëta të besimit u shprehën në drejtim të Policisë së Kosovës, organizatave jo-qeveritare (48%) dhe mediave (42%). Besimi në sektorin e biznesit qëndron në 30%. Shumica e të anketuarve mbeten mosbesues ndaj Kuvendit të Kosovës, Qeverisë dhe gjyqësorit. Besimi në sistemin zgjedhor dhe partitë politike është shqetësues me vetëm 13%.³⁹




Figura 45: Niveli i besueshmërisë në institucione/sectorë

³⁶ Asociacioni i Gazetarve Profesionist të Kosoves, Lajmet, <http://www.apik.org/?cid=1,5,168>

³⁷ Freedom House, Kosovo Overview, <http://www.freedomhouse.org/report/freedom-world/2013/kosovo>

³⁸ Transparency International, Andrew McDevitt –Blerja e ndikimit: Zgjedhjet në Ballkan,2012, http://issuu.com/transparencynetwork/docs/2013_buyinginfluence_crisisbalkans

³⁹ Huluntimi i Qendrës për studime të Sigurisë, Barometri Kosovar i Sigurisë, 2013,

http://www.qkss.org/repository/docs/Barometri_Kosovar_i_Siguirs%C3%AB- Z%C3%ABrat_e_Kosov%C3%ABs-V%C3%ABshtrimet_dhe_P%C3%ABrceptimet_864612.pdf

Në anën tjetër ‘Raporti i Pulsit Publik’ (UNDP, 2013) në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, thekson se krahasuar me tetorin e vitit 2012, kur 48% e serbëve mendonin që ‘marrëdhëniet ndëretnike janë të tensionuara dhe nuk po përmirësohen’, në prill 2013 kjo përqindje është ulur në 38%. Trend i kundërt është shënuar dhe tek popullata shqiptare. Sipas rezultateve të anketës së fundit rreth 72% prej tyre mendojnë që ‘marrëdhëniet ndëretnike janë të tensionuara dhe nuk po përmirësohen’.⁴⁰

Ndërsa, kur flitet për diskriminim, sipas po të njejtit raport, ka pasur një rritje në përqindjen e komuniteteve tjera të cilët besojnë që kanë qenë të diskriminuar në gjashtë muajt e kaluar (24%). Rezultatet tregojnë që kosovarët ndjehen të diskriminuar për këto arsye: vendbanimi, statusi i personit të zhvendosur apo emigrantit, satusit social apo shëndetësor (31%), mosha (17%), gjinia (15%), mendimi politik apo mendimet tjera (9%), feja (8%), përkatësia etnike (6%), gjuha (4%), dhe aftësitë e kufizuara (3%).⁴¹

Në fund, niveli i besimit ndërpersonal midis qytetarëve të Kosovës mbetet në nivel shumë të ulët. Sipas hulumtimit të popullsisë të ndërmarrë për nevoja të këtij studimi, vetëm 10.9% të qytetarëve të Kosovës mendojnë që kur kanë të bëjnë me të tjerët, nuk kanë nevojë që të jenë shumë të kujdesshëm. Rezultat të ngjajshëm ka nxjerrë edhe Indeksi i Shoqërisë Civile të CIVICUS për Kosovë në vitin 2011, ku niveli i besimit ndërpersonal ka qenë 9.1%. Përderisa baza e shoqërisë civile është ndërveprimi në mes të disa qytetarëve, ky nivel tepër i ulët i besimit midis njerëzve mund të jetë një nga arsyet për vështirësitë në fillimin dhe/ose mbajtjen e veprimeve të përbashkëta, në mes të qytetarëve por edhe OSHC-ve. Një nga arsyet potenciale të përmendura për këtë gjatë vitit 2011 ka pasur të bëjë me dallimin në mes të pritjeve dhe realitetit gjatë dekadës së fundit, ku njerëzit kanë përjetuar zhgënjime si pasojë e stagnimit të përgjithshëm ekonomik dhe politik të viteve të fundit.

⁴⁰UNDP, Raporti i Pulsit Publik 6, 2013 http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Procurement/PPR6_Shqip.pdf

⁴¹Ibid.

VI. SHTOJCAT

BIBLIOGRAFIA:

BCSDN (2012): Strategjitë dhe praktikat e Donatorëve në zhvillimin e Shoqërisë Civile në Ballkan, Shoqëria Civile: E humbur në përkthim.

Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2014 (2013): Financimi i investimeve kapitale 2013-2015.

CIVIKOS (2013): Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile.

EU Bussiness (2013): Pasqyra ekonomike për Kosovën.

FORUM 2015 (2013): Kush mbikëqyr mbikëqyrësit? - Studim mbi llogaridhënien e shoqërisë civile në Kosovë.

Freedom House (2013): Liria në botë 2013- Pasqyra për Kosovën.

Instituti RIINVEST (2012): Analizë e Kornizës Ligjore për Çështjet Fiskale të OJQ-ve në Kosovë.

Instituti GAP (2013): Buxheti i Kosovës, Transparenca dhe Format e Raportimit Buxhetor.

KCSF-CIVICUS (2011): Indeksi i Shoqërisë Civile, Qeverisje më e mirë për një ndikim më të madh.

KIPRED (2013): Analizë gjithëpërfshirëse e EULEX-it: Çka më tutje?

KCSF - Universiteti i Londrës Queen Mary (2012, i papublikuar si i veçantë): Strategjitë dhe praktikat e qëndrueshme të donatorëve për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.

Qendra për Studime të Sigurisë (2013): Barometri Kosovar i Sigurisë.

Qeveria e Kosovës, ZKM (2012): Raport gjithë përfshirës institucioneve publike për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike për vitin.

Qeveria e Kosovës-CIVIKOS (2013): Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile.

Transparency International (2012): Andrew McDevitt –Blerja e ndikimit: Zgjedhjet në Ballkan.

UNDP (2013): Raporti i Pulsit Publik 6.

LISTA E TË INTERVISTUARËVE:

1. Arben Lila	KADC
2. Ajtene Shabani	Administrata Tatimore e Kosovës
3. Behxhet Binaku	HANDIKOS
4. Behxhet Gaxhiqi	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
5. Burim Seferi	Kryqi i Kuq i Kosovës
6. Driton Selmanaj	Instituti Demokratik i Kosovës
7. Driton Bajraktari	Down Syndrom Kosova
8. Faik Hoti	Ministria e Shëndetësisë
9. Gani Asllani	ATRC
10. Gani Lluga	ASTRA
11. Hajrulla Çeku	EC MA NDRYSHE
12. Habit Hajredini	Zyra për Qeverisje të Mirë/ZKM
13. Isuf Zeriqi	Administrata Tatimore e Kosovës
14. Jusuf Thaqi	ENCOMPASS
15. Kushtrim Kaloshi	ATRC
16. Labinot Krasniqi	OJQ KOHA
17. Muhamet Arifi	Balkan Sunflowers
18. Naime Sherifi	Qendra për Mbrojtjen e Gruas dhe Fëmijut
19. Petrit Tahiri	Qendra Kosovare për Arsim
20. Petrit Zogaj	Lëvizja FOL
21. Qerkin Berisha	Ministria e Financave
22. Rexhep Bllaca	Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë
23. Shqipe Pantina	QPA
24. Shkumbin Spahija	KADC
25. Valdete Idrizi	Platforma CiviKos
26. Vjollca Çavolli	STIKK
27. Zef Shala	Nëna Terezë

LISTA E PJESËMARRËSVE NË TAKIMIN VALIDUES:

1. Lis Balaj	IPKO Foundation
2. Rinor Beka	NDI
3. Driton Bajraktari	Down Syndrom Kosova
4. Habit Hajredini	Zyra për Qeverisje të Mirë/ZKM
5. Trendelina Dreshaj	Zyra për Qeverisje të Mirë/ZKM
6. Sami Salihu	Administrata Tatimore e Kosovës
7. Ardita Metaj-Dika	TACSO
8. Visar Sutaj	D4D
9. Ardian Arifaj	Kolumnist/Aktivist për të drejtat e njeriut
10. Hamide Latifi	Gratë në Biznes
11. Lirije Ajeti	DRNOJQ
12. Minire Ahmetxhekaj	DRNOJQ
13. Skender Perteshi	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
14. Lorik Bajrami	Çohu
15. Avni Zogiani	Çohu
16. Driton Selmanaj	Instituti Demokratik i Kosovës
17. Petrit Tahiri	Qendra Kosovare për Arsim
18. Besart Lumi	Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut
19. Petrit Zogaj	Lëvizja FOL
20. Valdete Idrizi	Platforma CiviKos
21. Brikenda Rexhepi	TACSO
22. Hilmi Jashari	CRP/K
23. Iliriana Gashi	Women for Women International
24. Besnike Koçani	KCSF
25. Nita Luci	Univerziteti i Prishtinës
26. Florina Duli	Iniciativa Kosovare për Stabilitet
27. Bardhyl Kabashaj	Për Mendje të Shëndoshë
28. Venera Hajrullahu	KCSF
29. Valon Murati	Qendra për të Drejta të Njeriut në UP
30. Ardiana Shala	BSFK
31. Saranda Cana	Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë
32. Nora Sahatçiu	UNDCO
33. Taulant Hoxha	KCSF



Hulumtimi i popullsisë për Indeksin Kosovar të Shoqërisë Civile u mundësua nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) – Zyra në Kosovë, nëpërmjet përfshirjes së pyetjeve relevante në pyetësorët e Pulsit Publik 2013.

Grumbullimi i një pjese të të dhënave për Indeksin Kosovar për Shoqëri Civile u ndihmua nga Qendra e KCSF-së, me përkrahjen financiare të Ambasadës Mbretërore të Norvegjisë në Kosovë.

PËRKRAHUR NGA:

B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND